# RAPORTI I PUNËS I AGJENCISË SË ZBATIMIT TË GJUHËS QË E FLASIN SË PAKU 20 % E QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2019

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE

PJESA 1

1.1. Hyrje 6-6
1.2. Hapësirat e punës së AZGJ-së 7-9
1.3. Historia 9-9
1.4. Misioni 10-10
1.5. Vizioni 10-10

PJESA 2

2.1. Statusi 11-11
2.2. Udhëheqja 11-11
2.3. Detyrat dhe obligimet e AZGJ-së 11-11
2.4. Specifika e AZGJ-së 12-12
2.5. Parimet dhe vlerat në punë 12-12

PJESA 3

3.1. Vendosja organizative 13-14
3.2. Gjendja me kuadrin 15-17
3.3. Struktura e të punësuarve 17-20

PJESA 4

4.1. Pasqyra e punës 21-22
4.2. Kërkesat e pranuara për përkthim dhe lekturim 22-23
4.3. Mbështetje logjistike e organeve të qeverisjes qendrore, lokale dhe gjyqësore 24-24
4.4. Pyetësorët anketues drejtuar institucioneve të sektorit publik 24-26
4.5. Regjistri i përkthyesve dhe lektorëve në sektorin publik 26-26
4.6. Softueri i përkthimit – TRADOS 26-27
4.7. Ankesa 27-29

4.8. Informimi 29-29
4.9. Buletini mujor 29-30
4.10. Ueb faqja zyrtare 31-31
4.11. Publikimet e AZGJ-së 31-31

PJESA 5

5.1. Takime, ngjarje dhe vizita 32-34
5.2. Aktivitetet nga puna e AZGJ-së 34-109

PJESA 6

6.1. Buxheti, llogaria përmbyllëse dhe financimi 110-112
6.2. Furnizimet publike 112-113

PIKËPAMJE PËRFUNDIMTARE

## PARATHËNIE

Para jush është Raporti i parë vjetor për Punën e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019, që paraqet kontrollin gjithëpërfshirës të aktiviteteve dhe përpjekjeve të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave gjuhësore, në realizimin më të mirë të të drejtave gjuhësore, përforcimin e kapaciteteve të përkthimit të institucioneve dhe mbështetjen e të gjitha njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut për të bërë të mundur realizimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve.

Agjencia është e vendosur në qëllimin që në mënyrë aktive të veprojë në shërbim të demokracisë dhe sundimit të së drejtës nëpërmjet promovimit dhe përforcimit të të drejtave gjuhësore për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në vitet e kaluara, institucionet shtetërore vazhdimisht angazhoheshin në krijimin e një baze të mjaftueshme ligjore për përdorimin zyrtar të gjuhëve, si në nivel qendror, ashtu edhe në atë lokal.

Republika e Maqedonisë së Veriut tanimë ka legjislacion më të përparuar me të cilin në mënyrë më të qartë rregullohet përdorimi i gjuhëve në institucione. Sado që të jetë e plotë kjo infrastrukturë ligjore për përdorimin e gjuhëve, prapëseprapë, gjatë realizimit praktik, shfaqen vështirësi dhe sfida të ndryshme. Kjo nënkupton se është e nevojshme të bëhen përpjekje më të mëdha për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, që janë promovimi, mbrojtja dhe zbatimi i unifikuar i gjuhës zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (gjuhës shqipe).

Në vazhdim mund ta lexoni raportin në të cilin japim një pasqyrë të detajuar të të gjitha aktiviteteve të ndërmarra, nëpërmjet komponentëve të komunikimit, mbikëqyrjes dhe ndërmjetësimit. Janë dhënë një sërë rekomandimesh për institucione të caktuara. Ne do të vazhdojmë të këmbëngulim që Ligji i Përdorimit të Gjuhëve të zbatohet në të gjitha institucionet dhe shpresojmë se në bashkëpunim me institucionet dhe qytetarët, do t'ia dalim në përpjekjet tona.

**Me respekt,**

**Prof. dr. Ylber Sela**

# PJESA 1

## 1.1. Hyrje

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut[1] (në vazhdim të tekstit: AZGJ) e themeluar në përputhje me ligjin, në cilësinë e personit juridik, kompetente për standardizimin dhe përdorimin e unifikuar të gjuhës që flitet nga së paku 20 % e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të alfabetit të saj.

Raporti i referohet periudhës nga 1.1.2019 deri më 31.12.2019 dhe është përgatitur në bazë të nenit 18 paragrafi (4) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 07/19), sipas së cilit AZGJ-ja, për punën e saj, i dorëzon raport Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të paktën një herë në vit deri më 31 mars të vitit rrjedhës për vitin e kaluar.

Raporti Vjetor i Punës së AZGJ-së për vitin 2019 jep një përmbledhje të aktiviteteve të kësaj agjencie në zbatimin e kompetencave të saj ligjore me qëllim realizimin e të drejtave gjuhësore të gjuhëve zyrtare, zbatimin e vazhdueshëm të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, forcimin e aftësive të përkthimit të institucioneve, etj.

AZGJ-ja në punën e saj ishte e vendosur që të punojë në mënyrë aktive në shërbim të demokracisë dhe sundimit të së drejtës duke promovuar të drejtat gjuhësore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përkundër të gjitha përpjekjeve të AZGJ-së, gjetjeve tona në terren, ankesave të qytetarëve, raporteve të medieve dhe organizatave joqeveritare, përsëri, shumë qytetarë vazhdojnë të përballen me vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre të garantuara me ligj në komunikimin e tyre të përditshëm me institucionet. Kjo tregon se është e nevojshme të bëhet shumë përpjekje në të gjitha institucionet, deri në arritjen e qëllimeve të përcaktuara me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Duke u nisur nga qëllimi për zgjidhjen e problemeve institucionale që lidhen me numrin e pamjaftueshëm të përkthyesve në institucione dhe të cilësisë së dobët të përkthimeve dhe të lekturës së dokumentacionit zyrtar, AZGJ-ja ka ndërmarrë veprime për të forcuar kapacitetet e saj të përkthimit duke blerë softuer të përkthimit maqedonisht-shqip, me të cilin, në mënyrë të konsiderueshme do të lehtësohet dhe reduktohet koha e nevojshme për përkthim të dokumentacionit zyrtar.

[1] Emri zyrtar i shkurtër: Agjencia e Zbatimit të Gjuhës së RMV-së

## 1.2. Hapësirat e punës së AZGJ-së

Selia e AZGJ-së e RMV-së gjendet në shëtitoren "Dimitar Vllahov" nr. 4, kati i katërt, Komuna e Qendrës - Shkup, në objektin ku më herët ishte e sistemuar Drejtoria e Policisë Financiare, prapa Arkivit Shtetëror.

Fillimi i punës ishte shumë i vështirë për shkak të gjendjes së pavolitshme të hapësirave të punës, mungesës së inventarit, pajisjeve teknike dhe atyre ndihmëse të punës, infrastrukturës së brendshme të vjetruar, hapësirës joreprezentative të punës, gjë që mund të vërehet edhe nga materiali fotografik i dhënë.



*Hapësirat e gjetura të punës në AZGJ*

Për shkak të kësaj situate të gjetur, ishte e nevojshme të bëhet rinovimi i hapësirave të punës për t'i siguruar kushtet e nevojshme të punës për të punësuarit. Në vazhdim është paraqitur materiali fotografik i hapësirave të punës pas mbarimit të rinovimit.



*Pamja e hapësirave të punës së AZGJ-së pas mbarimit të rinovimit*

Me vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të miratuar në Seancën e 124-të, të mbajtur më 5 mars 2019, AZGJ-së iu dhanë zyrat e vjetra të Drejtorisë së Policisë Financiare në adresën: Shëtitorja "Dimitar

Vllahov" nr. 4, kati i katërt, Qendër, Shkup. Që nga fillimi i saj, selia formale e AZGJ-së ka qenë në Bulevardin e Ilindenit nr.2 / kulla 6 – zyra 410.

Në Seancën e 162-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 5 nëntor 2019, Qeveria miratoi Vendimin nr. 45-8714 / 1 për përdorimin e përhershëm të pasurive të patundshme të AZGJ-së ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 236/19), i cili ishte baza për regjistrimin e ndryshimit të selisë së AZGJ-së, me të cilin me Aktvendim të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 30120190016864 më datë 21.11.2019 është bërë regjistrimi i ndryshimit të selisë së AZGJ-së në adresën e re: Shëtitorja "Dimitar Vllahov" nr. 4, kati i katërt, Qendër, Shkup.

### 1.3. Historia

Më 6 shkurt 2019 u botua thirrja publike për emërimin e drejtorit të AZGJ-së, e cila përfundoi më 13 shkurt 2019, me zgjedhje të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 25 shkurt 2019, ku zgjodhi prof. dr. Ylber Selën si drejtor të parë të AZGJ-së.

Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut emëroi Pleurat Ajazin dhe Armend Fazliun për t'i ndjekur procedurat e nevojshme për krijimin e AZGJ-së. Për më tepër, u zgjodhën edhe tre këshilltarët e jashtëm të drejtorit, prof. dr. Izer Maksuti, prof. dr. Nuri Bexheti dhe prof. dr. Ajten Hajdari-Qamili, si dhe bashkëpunëtorët Emer Mustafa, Berna Mejdiu, Lirim Shabani dhe Ariton Spahiu.

Më datë 11 Mars 2019, u paraqit një kërkesë për themelimin e AZGJ-së në Regjistrin Qendror, dhe Aktvendimi për regjistrimin e themelimit të AZGJ-së u miratua më datë 13 Mars 2019. Data formale e themelimit të AZGJ-së është 14 janari 2019, pra dita e hyrjes në fuqi e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 7/19).

Më datë 21 nëntor 2019, u ndryshua selia e AZGJ-së dhe tani ndodhet në adresën: Shëtitorja "Dimitar Vllahov" nr. 4, kati i katërt, Shkup, dhe gjithashtu është shkruar emri i shkurtuar i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe quhet Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## 1.4. Misioni

Misioni i AZGJ-së është ndihma dhe mbështetja praktike në zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në institucionet shtetërore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, institucionet dhe organizatat, komisionet, personat juridikë që kryejnë autorizim publik, si dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, për të shpjeguar, sugjeruar dhe orientuar me kompetencë për të gjitha rastet e nevojshme që paraqiten në përdorimin e tij institucional; të kujdeset për gjuhën që e flasin së paku 20 % e qytetarëve (gjuhën shqipe); ta avancojë përdorimin zyrtar të gjuhës si një e drejtë themelore e qytetarëve.

## 1.5. Vizioni

AZGJ-ja si një person juridik, përgjegjëse për standardizimin dhe përdorimin e unifikuar të gjuhës të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të alfabetit të saj, me cilësinë e shërbimeve, efektivitetin dhe efektshmërinë në punë, me kapacitetet e saj me kuadër dhe atyre teknike synon të njihet si institucion me rëndësi strategjike në procesin e zbatimit të standardizuar dhe të unifikuar të gjuhëve zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

## PJESA 2

### 2.1. Statusi

AZGJ-ja është në cilësinë e personit juridik me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të përcaktuara me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

### 2.2. Udhëheqja

AZGJ-në e udhëheq drejtori i emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me mandat katërvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Për punën e tij dhe atë të AZGJ-së, ai i përgjigjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### 2.3. Detyrat dhe obligimet e AZGJ-së

Në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, AZGJ-ja është kompetente për kryerjen e këtyre punëve:

– Mbështetjen e institucioneve për realizimin e detyrimeve të këtij ligji, duke përfshirë përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve;
– Lekturimin e të gjithë akteve të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
– Promovimin dhe marrjen e masave për avancimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
– Përgatitjen e raportit për informimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e kompetencave të saj;
– Përgatitjen e materialit profesional-analitik nga kompetencat e saj për nevojat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
– Dhënien e mendimeve profesionale për materialet që janë në funksion të zbatimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20 % e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut; dhe
– Punë të tjera që lidhen me zbatimin e qëllimeve të përcaktuara me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Krahas kompetencave të saj ligjore, agjencia kujdeset për sigurimin e vazhdueshëm të funksionalitetit dhe forcimin e kapaciteteve të veta.

## 2.4. Specifika e AZGJ-së

AZGJ-ja ndërton një mjedis institucional që respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, mbron, promovon, ruan dhe forcon të drejtën gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më datë 14.1.2019, në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 07/19 u shpall dhe hyri në fuqi Ligji i Përdorimit të Gjuhëve me të cilin AZGJ-ja ka fituar cilësinë e personit juridik me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë ligj.

## 2.5. Parimet dhe vlerat në punë

– Ligjshmëria;
– Profesionalizmi dhe kompetenca;
– Përfaqësimi i duhur dhe i drejtë;
– Shërbimet e orientuara;
– Etika profesionale, paanshmëria dhe objektiviteti;
– Transparenca dhe besueshmëria;
– Përgjegjësia;
– Parandalimi i konflikteve të interesit;
– Të qenit ekonomik;
– Respektimi i standardeve të menaxhimit të cilësisë dhe
– Korniza e përbashkët për vlerësimin e punës.

## PJESA 3

### 3.1. Vendosja organizative

Duke u nisur nga kompetencat e përcaktuara në Ligjin e Nëpunësve Administrativë, si dhe nga Dekreti mbi parimet e organizimit të brendshëm të organeve të administratës shtetërore, e me qëllim të bashkimit të disa funksioneve të ndërlidhura ndërmjet tyre, organizimin, ndjekjen dhe koordinimin me burimet njerëzore, punën profesionalo-analitike, administrative, informative-komunikuese, operative, materiale, financiare, informatiko-teknologjike, profesionalo-administrative dhe punët e tjera, në pajtim me Rregulloren e organizimit të brendshëm të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20 % e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, AZGJ-ja është e organizuar në 4 (katër) sektorë me 9 (nëntë) njësi në përbërje të tyre dhe 2 (dy) njësi të pavarura, siç vijojnë:

(1) Sektori i mbështetjes të drejtorit, me njësitë në vazhdim:

– Njësia e bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
– Njësia e mbështetjes së drejtorit; dhe
– Njësia e marrëdhënieve me publikun.

(2) Sektori i planifikimit, koordinimit dhe zhvillimit, me njësitë në vazhdim:

– Njësia e avancimit të zbatimit të qjuhës që e flasin së paku 20 % e qytetarëve dhe
– Njësia e teknologjisë informatike


(3) Sektori i përkthimit dhe i lekturës, me njësitë në vazhdim:

– Njësia e përkthimit dhe
– Njësia e lekturës.

(4) Sektori i punëve të përgjithshme, juridike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, me njësitë në vazhdim:
– Njësia e punëve të përgjithshme dhe juridike dhe
– Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Njësitë e pavarura janë:
– Njësia e çështjeve financiare dhe
– Njësia e revizionit të brendshëm.

# Organogrami i AZGJ-së



### 3.2. Gjendja me kuadrin

Në Rregulloren e sistematizimit të vendeve të punës në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, janë paraparë 74 vende të punës. Nga numri i përgjithshëm i vendeve të parapara të punës, 71 vende të punës janë paraparë me statusin e nëpunësve administrativë, ndërsa 3 vende të punës janë me statusin e personit për ndihmë teknike. Në AZGJ, deri më 31.12.2020 janë punësuar gjithsej 15 persona me statusin e nëpunësve administrativë.

Deri më 31.1.2020, përqindja e vendeve të plotësuara të punës me realizues për kohë të pacaktuar është 20,27 % nga numri i planifikuar i realizuesve.

Plotësimi i vendeve të punës në agjenci, i shprehur me numrin e realizuesve sipas njësisë organizative, përfshirë më datën 31.12.2019 është si vijon:

- Këshilltarë shtetëror – 2
- Sektori i mbështetjes së drejtorit – 4
- Sektori i planifikimit, koordinimit dhe zhvillimit – 4
- Sektori i përkthimit dhe lekturës – 4
- Sektori i punëve të përgjithshme, juridike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore – 1
- Njësia e bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Njësia e mbështetjes të drejtorit
- Njësia e marrëdhënieve me publikun
- Njësia e avancimit të gjuhës që e flasin së paku 20 % e qytetarëve
- Njësia e teknologjisë informatike
- Njësia e përkthimit
- Njësia e lekturës
- Njësia e punëve të përgjithshme dhe juridike
- Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore
- Njësia e çështjeve financiare
- Njësia e revizionit të brendshëm

Me punësimin e parë me vendim në AZGJ, të realizuar me marrje të përhershme të vendit të punës: Udhëheqës i Njësisë së burimeve njerëzore, zyrtarisht ka filluar realizimi i detyrave dhe obligimeve të Njësisë së burimeve njerëzore në agjenci.

Gjatë vitit 2019 janë shpallur gjithsej 6 konkurse për punësimin e nëpunësve administrativë, katër nga të cilat janë realizuar plotësisht, ndërsa dy të tjerat janë në procedurë.

Në konkursin e parë, nga gjithsej 13 vende të punës, me vendim janë pranuar 7 nëpunës administrativë, ndërsa për 6 të tjerë, për shkak të mosplotësimit të kritereve të punës, konkursi është përsëritur.

Në konkursin e dytë, të tretë dhe të katërt, të shpallur më 29, 30 dhe 31 nëntor, janë pranuar gjithsej 6 nëpunës administrativë.

Nëpërmjet marrëveshjes për marrje të përhershme, gjithsej janë punësuar 2 nëpunës administrativë.

Sipas planit të agjencisë, deri në fund të vitit 2019 u shpall konkurs edhe për 2 (dy) nëpunës administrativë, të cilët, bashkë me 15 (pesëmbëdhjetë) nëpunësit e pranuar administrativë në konkurset e lartpërmendura, numri i të punësuarve do të arrinte në 17 (shtatëmbëdhjetë).

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019 janë përpunuar dhe nënshkruar gjithsej:

- 22 kontrata në vepër;
- 4 kërkesa për transferin e nëpunësve në institucione të ndryshme;
- 8 kërkesa drejtuar Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës;
- 8 kërkesa drejtuar Ministrisë së Financave dhe shumë kërkesa të tjera për qeverinë dhe institucionet e tjera.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në bazë të Programit vjetor për trajnim të përgjithshëm të nëpunësve administrativë, të miratuar nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, përgatit një plan vjetor për trajnimin e nëpunësve administrativë, pas mendimit të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

**Tabela 1.** Pasqyrë e vendeve të punës/realizuesve të sistematizuar/ të paraparë dhe të plotësuar në AZGJ për vitin 2019 nga këshilltarët shtetërorë dhe sektorët

| Titulli/ Njësia organizative | Vendet e punës të sistematizuara 31.12.2019 | Numri i realizuesve të sistematizuar 31.12.2019 | Numri i plotësuar i realizuesve 31.12.2019 |
|---|---|---|---|
| Këshilltarë shtetërorë | 3 | 3 | 2 |
| Sektori i mbështetjes së drejtorit | 13 | 14 | 4 |
| Sektori i planifikimit, i koordinimit dhe i zhvillimit | 7 | 7 | 4 |
| Sektori i përkthimit dhe i lekturës | 8 | 26 | 4 |
| Sektori i punëve të përgjithshme, juridike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore | 11 | 11 | 1 |


### 3.3. Struktura e të punësuarve

Sipas kategorive të vendeve të punës të nëpunësve administrativë (sipas numrit të personave):

– Nëpunës udhëheqës administrativ – 10
– Nëpunës profesional administrativ – 5
– Nëpunës ndihmës profesional administrativ – 0
– Persona ndihmës teknik – 0

Sipas shkallës së arsimit (sipas numrit të personave):

– Me arsim të lartë – 15
– Me shkollë të mesme – 0
– Me shkollë fillore – 0



Sipas gjinisë: (sipas numrit të personave):

– Mashkullore – 9
– Femërore – 6






Tabela 2. Pasqyrë e strukturës së të punësuarve në AZGJ deri më 31.12.2019

| Kategoritë e vendeve të punës | Gjinia | | Shkalla e arsimit | | | GJITHSEJ |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | M | F | Të lartë | Të mesëm | Fillor | |
| Udhëheqës | 5 | 5 | 10 | 0 | 0 | 10 |
| Profesional | 4 | 1 | 5 | 0 | 0 | 5 |
| Ndihmës profesional | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ndihmës teknik | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| GJITHSEJ | 9 | 6 | 15 | 0 | 0 | 15 |


16
14
12
10
8
6
4
2
0
m
f
të lartë
mesëm
fillor
gjinia
niveli i arsimit
Udhëheqës
Profesional
Ndihmës profesional
Ndihmës teknik
GJITHSEJ

## PJESA 4

### 4.1. Pasqyra e punës

AZGJ-ja gjithmonë përpiqet të sigurojë realizimin efektiv dhe efikas të detyrimeve ligjore kryesore, por gjithashtu edhe të zhvillojë e forcojë vazhdimisht kapacitetet e veta.

Qëllimet parësore dhe zhvillimore të AZGJ-së dalin nga kompetencat e saj ligjore dhe përqendrohet në zbatimin e plotë dhe të vazhdueshëm të rregullores ligjore për zbatimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve, por edhe në konsolidimin dhe forcimin vetanak të kapaciteteve për kryerjen e funksioneve të saj. Në këtë kontekst, AZGJ-ja ka vendosur disa qëllime strategjike afatmesme dhe afatshkurtra që duhet realizuar në periudhën 2020-2022:


- Ndjekja e vazhdueshme e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve;
- Zbatimi i praktikave më të mira vendore dhe ndërkombëtare, në kontekstin e aktiviteteve që po ndërmerren në proceset e integrimit në BE dhe NATO;
- Promovimi dhe zhvillimi i sistemit për zbatimin aktiv të gjuhëve zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Avancimi i funksionimit dhe realizimit të kompetencave të AZGJ-së, duke siguruar mbështetje administrative, logjistike dhe atë teknike;
- Forcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore nëpërmjet punësimeve të reja, vendosjeve dhe përmirësimeve, bazuar në parimin profesional dhe në kompetencën, duke zbatuar parimin e përfaqësimit të drejtë të anëtarëve të bashkësive, si dhe nëpërmjet zhvillimit profesional të punonjësve të AZGJ-së;
- Forcimi i punëve financiare dhe materiale, si dhe përmirësimi i procesit të planifikimit strategjik në AZGJ, i integruar me avancimin e veprimtarive për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e menaxhimit dhe të kontrollit financiar;
- Përmirësimi i funksionimit të AZGJ-së duke rritur efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe respektimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe akteve të brendshme dhe kontratave;

- Vendosja e programeve për stafin e AZGJ-së për t'i zhvilluar aftësitë sistematike, njohuritë dhe sjelljet e tyre të nevojshme për t'i përmbushur qëllimet afatmesme dhe afatgjata;
- Ruajtja dhe zhvillimi i partneritetit strategjik me palët e interesuara përkatëse, përfshirë ministritë dhe organet e tjera shtetërore, odat ekonomike, sektorin e OJQ-ve dhe donatorët.

## 4.2. Kërkesat e pranuara për përkthim dhe lekturim

Gjatë vitit 2019 një numër i madh i institucioneve kanë dorëzuar kërkesa në AZGJ për ndihmë në përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve zyrtare.

| Numri i kërkesave të arritura për përkthim | Përqindja e përkthimeve të realizuara | Numri i kërkesave të arritura për lekturim | Përqindja e kërkesave të realizuara për lekturim |
|---|---|---|---|
| 144 | 100 % | 19 | 100 % |




Gjatë vitit 2019 AZGJ-ja ka punuar në funksion të zbatimit të përgjegjësive të saj, si:

- Mbështetja e institucioneve për realizimin e detyrimeve në bazë të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, duke përfshirë përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve;
- Lekturimi i akteve qëshpallen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut";
- Promovimi dhe marrja e masave për avancimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20 % e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Përgatitja e raporteve për informimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Përgatitja e materialeve profesionale analitike nën kompetencat e saj;
- Dhënia e mendimeve profesionale për materialet që janë në funksion të zbatimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Ekipimi i kadrit dhe sigurimi i hapësirës me pajisje;
- Zbatimi i trajnimeve për përforcimin e kapaciteteve të të punësuarve;
- Furnizimi i pajisjeve IT (serverë, kompjuterë personalë dhe softuerë për ta dhe pajisje të tjera IT).

## 4.3. Mekanizmi i mbështetjes logjistike të organeve të pushtetit qendror, gjyqësor dhe lokal

AZGJ-ja për vitin 2019 përgatiti një projekt nga i cili u zhvillua një mekanizëm i ri për mbështetjen logjistike e cila do t'i ndihmojë AZGJ-së në zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në organet e pushtetit qendror, lokal dhe gjyqësor. Mekanizmi i mbështetjes logjistike është motivuar nga hartimi i udhëzimeve, doracakëve dhe broshurave për të drejtat e qytetarëve në të cilat gjenden Ligji i Përdorimit të Gjuhëve dhe Ligji i Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhëve.

## 4.4. Pyetësorët anketues drejtuar institucioneve të sektorit publik

AZGJ-ja gjatë vitit 2019 ka dorëzuar gjithsej 641 pyetësorë anketues me një sërë pyetjesh të strukturuara drejtuar institucioneve të sektorit publik, me ç'rast kanë kthyer përgjigje gjithsej 183 institucione.

Nga përgjigjet e marra për pyetjen e parë: **A i keni përmbushur detyrimet në përputhje me nenin 7 të këtij ligji, dhe, nëse nuk i keni përmbushur plotësisht, deri në cilën fazë keni arritur me ndryshimin e tabelave të institucionit, memorandumet, vulat, logot dhe ueb faqet?**

–147 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar tabelat, 36 jo;
–119 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar memorandumet, 64 jo;
–151 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar vulat, 32 jo;
–110 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar logot, 73 jo;
–113 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar ueb faqet, 70 jo.

Përgjigjet e marra nga pyetja e dytë: **Nëse nuk keni filluar me implementimin, a keni nevojë për ndihmë profesionale nga agjencia?**

– 27 institucione janë përgjigjur se kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së;
– 63 institucione janë përgjigjur se nuk kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së;
– 54 institucione nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje;
–26 institucione u përgjigjën se do të kërkojnë ndihmë nga AZGJ-ja sipas nevojës;
–13 institucione u përgjigjën se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përgjigjet e marra nga pyetja e tretë: **Në aktin tuaj për sistematizimin e vendeve të punës, a keni paraparë sektor ose njësi të përkthimit dhe lekturës në shqip dhe nga gjuha shqipe?**

–30 institucione janë përgjigjur se kanë paraparë sektor dhe njësi të përkthimit dhe lekturës në shqip dhe nga gjuha shqipe;
– 135 institucione u përgjigjën se nuk kanë paraparë sektor dhe njësi të përkthimit dhe lekturës në shqip dhe nga gjuha shqipe;
–18 institucione u përgjigjën se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përgjigjet e marra nga pyetja e katërt: **Nëse nuk e keni paraparë, a do ta bëni atë në ndryshimin e ardhshëm të aktit për sistematizimin e vendeve të punës?**

– 76 institucione janë përgjigjur se do ta parashohin ndryshimin e aktit të sistematizimit të vendeve të punës;
–31 institucione janë përgjigjur se nuk do ta parashohin ndryshimin e aktit për sistematizimin e vendeve të punës;
– 8 institucione nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje;
– 20 institucione janë përgjigjur se do ta parashohin ndryshim të aktit të sistematizimit të vendeve të punës, nëse është e nevojshme;
–23 institucione janë përgjigjur se tashmë kanë paraparë ndryshim të aktit të sistematizimit të vendeve të punës;
– 25 institucione janë përgjigjur se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përgjigjet e marra nga pyetja e pestë: **Sa përkthyes dhe sa lektorë keni të punësuar në institucionin tuaj?**

–124 institucione janë përgjigjur se nuk kanë të punësuar asnjë përkthyes dhe lektor;
– 23 institucione janë përgjigjur se kanë të punësuar një përkthyes dhe lektor;
– 11 institucione janë përgjigjur se kanë të punësuar dy përkthyes dhe lektorë;
– 1 institucion janë përgjigjur se ka të punësuar tre përkthyes dhe lektorë;
– 2 institucione janë përgjigjur se kanë të punësuar katër përkthyes dhe lektorë;
– 3 institucione janë përgjigjur se kanë të punësuar pesë përkthyes dhe lektorë;
– 1 institucion është përgjigjur se ka të punësuar 22 përkthyes dhe lektorë;
– 18 institucione janë përgjigjur se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përgjigjet e marra nga pyetja e gjashtë: **Në buxhetin e paraparë për vitin 2020, a keni paraparë mjete financiare për përkthyes dhe lektorë të rinj?**

– 43 institucione janë përgjigjur se kanë paraparë mjete financiare;
– 96 institucione janë përgjigjur se nuk kanë paraparë mjete financiare;

– 4 institucione janë përgjigjur se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje;
– 41 institucione nuk kanë dhënë asnjë përgjigje në lidhje me këtë pyetje.

Përgjigjet e marra nga pyetja e shtatë: **Si mund t'ju ndihmohet për të shpejtuar fazën e dytë të zbatimit të plotë të ligjit?**

– 21 institucione janë përgjigjur se kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së;
– 16 institucione janë përgjigjur se nuk kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së;
– 60 institucione nuk dhanë asnjë përgjigje në lidhje me pyetjen;
– 73 institucione janë përgjigjur se do të kërkojnë ndihmë nga AZGJ-ja në rast nevoje;
– 13 institucione janë përgjigjur se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Nga gjithsej 183 përgjigje të marra:

– 131 institucione janë përgjigjur vetëm në gjuhën maqedonase;;
– 4 institucione janë përgjigjur vetëm në gjuhën shqipe;
– 48 institucione janë përgjigjur edhe në gjuhën maqedonase edhe në gjuhën shqipe.

## 4.5. Regjistri i përkthyesve dhe lektorëve në sektorin publik

AZGJ-ja ka përgatitur një regjistër të personave me statusin e nëpunësve administratiëvë, persona të angazhuar në baza të tjera ose bashkëpunëtorë të jashtëm, të cilëve u janë deleguar detyra të përkthimi dhe lekturës nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

Një regjistër i tillë do t'i shërbejë AZGJ-së për të marrë një përmbledhje të plotë të situatës së kuadrit të përkthyesve dhe lektorëve në organet e qeverisjes qendrore, në mënyrë që ata të përfshihen në programet dhe trajnimet e ardhshme për përkthyesit dhe lektorët, të organizuar nga AZGJ-ja.

## 4.6. Softueri i përkthimit - TRADOS

Sistemet elektronike po përparojnë gjithnjë e më tepër dhe ndihmojnë në efikasitetin e punës, kështu që, me trajnimin e përkthyesve mund të lehtësohet përdorimi i pajisjeve elektronike (softuer), fjalorëve të strukturuar elektronikë,

bazës së integruar të fjalëve të specializuara nga fusha administrative, fusha e drejtësisë dhe metodave të lehta dhe të shpejta të përkthimit etj. Në këtë mënyrë, përkthimi do të jetë më i mirë dhe përkthyesit do të jenë më efikas në punën e tyre..

Në realizimin e qëllimit për efikasitet në përkthim, si dhe për të përmirësuar cilësinë e tij nga shqipja në maqedonisht dhe anasjelltas, AZGJ-ja ka blerë softuerin Trados i cili përmban një bazë të dhënash të specializuara të fjalorit të gjuhës shqipe dhe maqedonase. Qëllimi i instalimit të softuerit është të lehtësojë procesin e përkthimit nëpërmjet mekanizmave të memories së përkthimit.

AZGJ-ja aktualisht ka 25 licenca të përkthimit Trados me qëllim të vetëm për nevojat e AZGJ-së.

### 4.7. Ankesa

AZGJ për vitin 2019 pranoi 10 ankesa dhe 10 kërkesa për mendime këshilluese. Në bazë të përmbajtjes së ankesës përcaktohet nëse e ajo është në kompetencë të AZGJ-së. Parashtruesi i ankesës do të informohet në kohë për pranimin e ankesës, si dhe do të informohet nëse ankesa është në kompetencat e AZGJ-së. Nëse ankesa nuk është në kompetencë të saj, atëherë ajo do t'i përcillet autoritetit kompetent.

AZGJ-ja, në përputhje me kompetencat e saj, ka shqyrtuar ankesat e pranuara dhe kërkesat për mendime, si dhe pyetjet e ngritura nga qytetarët në lidhje me mosrespektimin e institucioneve për t'i respektuar të drejtat e gjuhës që i referohen:

- Mungesën e përkthimit të përmbajtjeve të ueb faqeve zyrtare në gjuhët zyrtare;
- Dilemat në lidhje me përkthimin e drejtë të emrave;
- Mungesën e ekzemplarëve dhe formularëve në procedurat para organeve publike në gjuhët zyrtare;

– Kufizimet në raport me zbatimin e gjuhës amtare që është gjuhë zyrtare, ndryshe nga maqedonishtja në komunikimin me organet e pushtetit shtetëror.

**Shembuj të kërkesave për mendime këshillëdhënëse**

Shembulli 1:

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës pranoi kërkesë nga Shoqëria Aksionare në Pronësi Shtetërore për Kryerjen e Veprimtarisë për Dhënien e Shërbimeve të Navigacionit Ajror SHA M-NAV Shkup, në të cilën kërkohej këshillë për përkthimin e drejtë të emrit të shoqërisë: **Акционерско друштво во државна сопственост за вршење на дејноста давање услуги во воздухопловната навигација М-НАВ АД Скопје.**

Në përputhje me qëndrimin e Sektorit të përkthimit dhe lekturës në suaza të AZGJ-së, përkthimi i drejtë i emrit të plotë të shoqërisë në shqip duhet të jetë **Shoqëria Aksionare në Pronësi Shtetërore për Kryerjen e Veprimtarisë për Dhënien e Shërbimeve të Navigacionit Ajror M-NAV SHA Shkup.**

Përkthimi i emrit të shkurtuar të shoqërisë **М-НАВ АД Скопје** në gjuhën shqipe duhet të jetë si më poshtë:**M-NAV SHA Shkup.**

Shembulli 2:

Fondi i Sigurimit Shëndetësor ka dorëzuar kërkesë për mendim rreth asaj nëse një anëtari të Bordit të Drejtorëve të Fondit, që merr pjesë në një mbledhje të organit të menaxhimit të fondit, e që duhet të pajiset me materialin punues për seancën, përveç në gjuhës maqedonase, a duhet ai t'i dorëzohet edhe në gjuhën shqipe dhe alfabetin e saj.

Nga ana e AZGJ-së është dhënë një mendim këshillëdhënës që në përputhje me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, duke marrë parasysh se bëhet fjalë për person, d.m.th. pjesëmarrës në një mbledhje të Bordit të Drejtorëve të Fondit, të caktuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili e flet gjuhën që e flasin të paktën 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të kërkohet të lejojnë pjesëmarrësin në procedurë, në rastin konkret në cilësinë e anëtarit të Bordit të Drejtorëve të Fondit që merr pjesë në një

mbledhje të organit të administrimit të fondit, t'i mundësohet që materiali i punës për seancë, përveç në gjuhën maqedonase, duhet t'i dorëzohet edhe në gjuhën shqipe dhe alfabetin e saj.


## 4.8. Informimi

AZGJ-ja në vazhdimësi ka punuar në ndërgjegjësimin e publikut dhe të institucioneve për të drejtat dhe obligimet e tyre gjuhësore. Komunikimi është realizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, me qytetarët dhe përfaqësuesit e institucioneve në mbledhje, diskutime, takime, vizita në terren dhe në forma të tjera të komunikimit.

## 4.9. Buletini mujor

AZGJ-ja çdo muaj përgatit buletinin e aktiviteteve mujore me qëllim të përmirësimit të transparencës në punë.

Buletini çdo muaj publikohet në faqen e AZGJ-së në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze dhe përmban një pasqyrë të shkurtër të aktiviteteve mujore.


Република Северна Македонија
Агенција за примена на јазикот што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните на Република Северна Македонија
Билтен
Септември 2019
Агенцијата за финансиска поддршка во земјоделството и руралниот развој, денеска ја посети Агенцијата...
Албанолошкиот институт во Приштина и Агенција за примена на јазикот ќе реализираат заеднички проекти
Примената на албанскиот јазик во Државниот инспекторат за труд – пример што треба да го следат...
Агенцијата за примена на јазикот пречека претставници од Форумот ЗФД
Агенцијата за примена на јазикот поврзана со институционална поддршка на Државниот завод за статистика
Посета на Агенцијата за вработување на Република Северна Македонија
Директорот на Агенцијата за примена на јазикот пречека претставници од Форумот ЗФД
Агенцијата за примена на јазикот повлекува институционална поддршка на Државниот завод за статистика
Посета на Агенцијата за вработување на Република Северна Македонија
Директорот на Агенцијата за поттикнување на развојот на земјоделството ја посети Агенцијата за...
Народниот правобранител ја поддржува работата на Агенцијата за примена на јазикот
Работна средба помеѓу Агенцијата за примена на јазикот и Пансеи Диалог Центар
Агенцијата за примена на јазикот пречека претставници на Одделението за човекови димензии на...
Се одржа втората средба со претставници на Високиот комесар на ОБСЕ за национални малцинства
Агенција за примена на јазикот ја промовираше Брошурата со информации за јазичните права на...
Соработка помеѓу Агенцијата за примена на јазикот и ЈСП „Скопје“, за примена на албанскиот јазик
Гостин на Агенцијата за примена на јазикот го посети првиот човек на Град Скопје, Петре Шилегов
БРОШУРА
Венецијанската комисија се интересира за Закон за употреба на јазици и Агенција за примена на...
Агенцијата за примена на јазикот и Здружението на преведувачи и толкувачи на Република Македонија ќе...


Republika e Maqedonisë së Veriut
Agjencia për Zbatimin e Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Buletin
Shtator 2019
Agjencia për Zbatimin e Gjuhës priti në takim përfaqësues nga Forumi ZFD
Agjencia për Zbatimin e Gjuhës priti përfaqësues të Seksionit të Dimensionit Njerëzor të Misionit të...
Agjencia për Mbështetjen Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sot vizitoi Agjencinë për...
Drejtori i Agjencisë së Nxitjes së Zhvillimit të Bujqësisë viziton Agjencinë për Zbatimin e Gjuhës
Komisioni i Venedikut interesohet për Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve dhe Agjencinë për Zbatimin e...
Agjencia për Zbatimin e Gjuhës ofroi mbështetje institucionale për Entin Shtetëror të Statistikës
Bashkëpunim ndërmjet Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës dhe NPQ "Shkupi", për zbatimin e gjuhës shqipe
Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Agjencia për Zbatimin e Gjuhës do të realizojnë projekte të...
U realizua takimi i dytë me përfaqësues të Komisionerit të Lartë të OSBE-së të Pakicave Kombëtare
Agjencia për Zbatimin e Gjuhës dhe Shoqata e Përkthyesve dhe Interpretuesve e Maqedonisë do të...

## 4.10. Ueb faqja zyrtare

Ueb faqja zyrtare e AZGJ-së www.apj.gov.mk dhe www.azgj.gov.mk vazhdimisht përditësohet me përmbajtje, ngjarje, takime pune, publikime, raporte dhe intervista të transmetuara në mediet elektronike.




## 4.11. Publikimet e AZGJ-së në vitin 2019



## PJESA 5

### 5.1. Takime, ngjarje dhe vizita

AZGJ-ja në vitin 2019 vendosi bashkëpunim me një numër të madh institucionesh dhe organizatash vendase dhe ndërkombëtare nëpërmjet realizimit të takimeve të punës, ngjarjeve, preskonferencave, udhëtimeve dhe vizitave zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë vendit.

Disa nga takimet, ngjarjet dhe vizitat e realizuara:

– Vizitë në Qytetin e Shkupit;
– Vizitë në Komunën e Kumanovës;
– Vizitë në Qendrën e Dialogut NANSEN;
– Takim në selinë e AZGJ-së me përfaqësuesit e NTP-së Shkup;
– Takim në selinë e AZGJ-së me Komisarin e Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare;
– Takim në selinë e AZGJ-së me Grupin Ndërkombëtar të Menaxhimit (MG - International Management Group);
– Vizitë Avokatit të Popullit;
– Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit pranë Universitetit të Evropës Juglindore në temë: Ndërgjegjësimi i publikut për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve;
– Vizitë Entit Shtetëror të Statistikës;
– Vizitë në Institutin Albanologjik të Prishtinës, Republika e Kosovës;
– Takim në selinë e AZGJ-së me delegacionin e Komisionit të Venecies;
– Takim në selinë e AZGJ-së me përfaqësuesit e Agjencisë së Nxitjes së Zhvillimit të Bujqësisë;
– Takim në selinë e AZGJ-së me përfaqësuesit e Forumit ZFD;
– Takim në selinë e AZGJ-së me përfaqësuesit e SHA e Menaxhimit të Hapësirës Afariste në Pronësi Shtetërore;
– Takim në selinë e AZGJ-së me përfaqësuesit e Dhomës së Përmbaruesve;
– Takim në selinë e AZGJ-së me përfaqësuesit e Postës së Maqedonisë së Veriut;

– Takim në selinë e AZGJ-së me përfaqësuesit e Këshillit të Europës;
– Takim në selinë e AZGJ-së me ambasadorin e Republikës së Kosovës;
– Takim në selinë e AZGJ-së me ambasadorin e Republikës së Shqipërisë;
– Takimi i drejtorit të AZGJ-së me kryetarin e RMV-së, Stevo Pendarovski;
– Vizitë në Regjistrin Qendror të RMV-së;
– Takim në selinë e AZGJ-së me përfaqësuesit e Agjencisë së Investimeve të Huaja dhe Promovimit të Eksportit;
– Vizitë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut ;
– Organizim i ngjarjes në selinë e AZGJ-së për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Përkthimit me një panel me temën: Sfidat e përkthimit në RMV;
– Organizimi i ngjarjes në selinë e AZGJ-së për të shënuar Ditën Europiane të Gjuhëve dhe për të promovuar një broshurë me informacione mbi të drejtat gjuhësore të qytetarëve të RMV-së;
– Vizitë në Agjencinë e Punësimit;
– Takim në selinë e AZGJ-së me përfaqësuesit e Shoqatës së Përkthyesve dhe Interpretuesve;
– Vizitë në Galerinë Kombëtare "Stacioni i Vogël";
– Vizitë në Zyrën e Shëndetit Elektronik;
– Vizitë në Inspektoratin Shtetëror të Inspektimeve Teknike;
– Vizitë në Fondin e Sigurimit Shëndetësor;
– Vizitë në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
– Vizitë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
– Vizitë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
– Vizitë e Komisionit të Letrave me Vlerë;
– Vizitë në Gjykatën Themelore Civile - Shkup;
– Vizitë në Gjykatën e Apelit - Shkup;
– Vizitë në Gjykatën Administrative;
– Vizitë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
– Vizitë në OKB dhe OSBE në Vjenë - Austri;
– Vizitë në Qendrën Kërkimore EURAC në Bolzano - Itali;
–Vizitë në Tiranë, Republika e Shqipërisë dhe takime me ministrin e Diasporës, Pandeli Majko, vizitë në Qendrën e Publikimeve Zyrtare; Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës, Akademinë e Studimeve të Albanologjisë, Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi";

– Takim në selinë e AZGJ-së me zëvendësambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë;
– Takim në selinë e AZGJ-së me ambasadorin e BE-së, Zhbogar;
– Takim në selinë e AZGJ-së me ambasadorin e Republikës së Finlandës;
– Takime në selinë e AZGJ-së me përfaqësuesit e misionit të OSBE-së në Shkup;
– Vizitë në ASHAM;
– Vizitë Drejtorisë së Ekzekutimit të Sanksioneve;
– Vizitë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;
– Vizitë Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe në Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë;
– Vizitë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve;
– Pjesëmarrja në manifestimin kulturo-shkencor "Dita e Alfabetit Shqip" në Manastir;
– Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, e cila dhuroi libra për nevojat e bibliotekës së AZGJ-së, me Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve dhe me Bibliotekën IK "Koço Racin" – Tetovë.

## 5.2. Aktivitetet nga puna e AZGJ-së

### *Vetëdijesimi i institucioneve dhe qytetarëve për zbatimin e ligjit*

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e Republikës së Maqedonisë së Veriut që nga themelemi i saj në vazhdimësi ka bërë vetëdijesimin e opinionit dhe institucioneve publike mbi të drejtat dhe detyrimet gjuhësore, si dhe rolin e saj në mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e zbatimit të drejtë të gjuhës. Komunikimi është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përfaqësuesit e institucioneve, në takime, biseda si dhe në debate të ndryshme, duke ndihmuar zbatimin praktik të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në institucionet shtetërore në përputhje me përcaktimet ligjore. AZGJ-ja, për interesin e shoqërisë ku

jetojmë, ka përgatitur edhe një broshurë dhe udhëzues për Zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhës për një imazh sa më pozitiv dhe për një nivel më të lartë të funksionimit të ligjit.

*17 qershor 2019*

**Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela mori pjesë në tryezën e organizuar në Universitetin e Europës Juglindore (UEJL)**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimin të Gjuhës, Ylber Sela mori pjesë në tryezën e organizuar në Universitetin e Evropës Juglindore (UEJL), gjegjësisht, nga Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, në bashkëpunim me Sekretariatin e Përgjithshëm të Qeverisë së RMV-së dhe Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, me temë: "Ngritja e vetëdijes publike për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve".

Me këtë rast, Sela tha se përmbushja e të drejtave gjuhësore është jetike për të siguruar pjesëmarrje të sigurt të të gjitha komuniteteve në shoqëri, ndonëse operimi në dy gjuhë zyrtare shfaq edhe vështirësi. " Meqenëse të drejtat gjuhësore janë pjesë integrale e së drejtës themelore të njeriut për lirinë e shprehjes, përmbushja e tyre është jetike, për të siguruar që pjesëtarët e të gjitha komuniteteve të mund të marrin pjesë në mënyrë efektive në shoqëri dhe të kenë qasje të barabartë në drejtësi. Operimi në dy gjuhë zyrtare është punë komplekse që kërkon burime të konsiderueshme buxhetore, ndryshime strukturore në institucione dhe në personelin e specializuar e të trajnuar", deklaroi Ylber Sela.



Më tej në diskutimin e tij, drejtori Sela përmendi disa nga aktivitetet e ndërmarra për mëkëmbjen e agjencisë.



“Disa nga aktivitetet që janë ndërmarrë për mëkëmbjen e kësaj agjencie janë të aspektit teknik: futja në Regjistrin Qendror, përpilimi i Rregullores mbi organizimin e brendshëm të agjencisë, krijimi i sektorëve dhe njësive në agjenci, përpilimi i Rregullores mbi sistematizimin e vendeve të punës, sigurimi i hapësirave të punës, lidhja e kontratave të domosdoshme për funskionimin e agjencisë, krijimi i vulave të agjencisë, miratimi i Planit të punësimit, krijimi i Planit financiar , krijimi i Programit të punës”, shtoi Sela.

Në përmbyllje, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela tha se janë duke u kërkuar mënyra për unifikimin e terminologjisë dhe për trajnimin e përkthyesve.

*27 qershor 2019*

**Takim i drejtorit të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës me kreun e Arkivit Shtetëror të RMV-së**

Sot në hapësirat e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës u mbajt takim ndërmjet drejtorit të saj, Ylber Sela, drejtorit të Arkivit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kirill Petrov dhe zëvendësdrejtorit të Arkivit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Muzafer Bislimi.



Në takim u diskutuan një sërë çështjesh, ndër të cilat edhe obligimet të cilat burojnë nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve. Agjencia e Zbatimit të Gjuhës shprehu gatishmërinë për t'ia dhënë mbështetjen e nevojshme Arkivit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut për përmbushjen e obligimeve ligjore, ndërsa Arkivi Shtetëror u zotua se do të mbështesë AZGJ-në në ndërtimin e kapaciteteve dhe kuadrove mbi punën arkivore dhe arkivin e saj.

*1 korrik 2019*

**Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës takohet me kryetarin e RMV-së**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, sot u takua me kryetarin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski. Ky takim u fokusua në kushtet lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve nga institucionet publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Drejtori Ylber Sela e informoi kryetarin Pendarovski për aktivitetet e deritashme të realizuara, si dhe për sfidat dhe planet e agjencisë gjatë zbatimit të ligjit.

Ai theksoi rëndësinë e zbatimit të ligjit nga ana e institucionit të kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shprehu bindjen se beson që institucionet e tjera në vend së shpejti do t'i rregullojnë veprimet e tyre sipas Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

*3 korrik 2019*

**Ambasadori i Shqipërisë vizitoi Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës**

Në ambientet e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës sot u zhvillua një takim ndërmjet drejtorit të saj, Ylber Sela, dhe Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Fatos Reka.




Ambasadori Reka shprehu gatishmërinë për bashkëpunim ndërmjet agjencisë dhe institucioneve përkatëse në Republikën e Shqipërisë në të ardhmen. Të dy bashkëbiseduesit në përfundim thanë se respektimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve jep një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe kultivimin e bashkëjetesës ndëretnike, si dhe në arritjen e objektivave strategjike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, anëtarësimin e plotë në NATO dhe Bashkimin Europian.

Ambasadori Reka theksoi se beson që, falë vendosmërisë dhe gatishmërisë së drejtorit të agjencisë dhe ekipit të tij, do të ketë përparim zbatimi i gjuhës shqipe, gjë e cila është në të mirë të vendit. “Për faktorin shqiptar në RMV është një arritje e madhe miratimi dhe zbatimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve dhe kjo paraqet një mundësi për zbatim të një gjuhe korrekte, standarde, pa dialektizma, siç e meriton gjuha shqipe”, tha ambasadori Reka.

*4 korrik 2019*

**Ambasadori i Republikës së Kosovës, Gjergj Dedaj, vizitoi Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, sot priti ambasadorin e Republikës së Kosovës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Gjergj Dedaj.

Në takim, drejtori i kësaj agjencie e njoftoi ambasadorin Dedaj mbi themelimin e institucionit, rolin e tij, misionin, masat e ndërmarra dhe për aktivitetet e ardhshme.



Ambasadori Dedaj i uroi sukses drejtorit të agjencisë dhe ekipit të tij, në ndërmarrjen e masave për zbatimin e ligjit, nga ana e institucioneve të shtetit. Dedaj tha se RMV-ja është vend fqinj i Kosovës dhe gjithmonë kanë bashkëvepruar në përparimin e vendeve për anëtarësim në NATO dhe BE. Prandaj, sipas tij, vendi duhet t'i respektojë ligjet dhe të drejtat gjuhësore.

"Maqedonia e Veriut, që të pranojë standardet europiane, duhet t'i miratojë dhe zbatojë ligjet për barazi gjuhësore, kulturore etj., gjë që edhe shpresojmë që Maqedonia e Veriut të anëtarësohet në NATO, e Kosova e mbështet fuqimisht", tha Dedaj. Barazia etnike dhe gjuhësore është një çështje thelbësore për funksionimin e një shteti, tha në fund ambasadori i Kosovës, Gjergj Dedaj.

*9 korrik 2019*

**Shefja e Këshillit të Europës në Shkup, Ana Zec, vizitoi Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës**

Këshilli i Europës në Shkup ka dhënë mbështetje të fuqishme dhe konstruktive për vendin gjatë respektimit të ligjeve dhe të drejtave njerëzore e gjuhësore, tha sot Ana Zec, shefja e Zyrës së Programit të Këshillit të Europës në takim me përfaqësuesit e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës.



Gjatë takimit u përshëndet bashkëpunimi i shkëlqyer ndërmjet të dy përfaqësuesve të institucioneve në aspektin e dialogut të intensifikuar për miratimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve dhe zbatimin e tij, si dhe bashkëpunimit të përforcuar me realizimin e projekteve rrjedhëse.

Drejtori i agjencisë, Ylber Sela, e informoi për gjendjen e brendshme, kushtet dhe kapacitetet e burimeve njerëzore, për agjendën e qeverisë në pikëpamje të përmbushjes së reformave të agjencisë.

Përfaqësuesja e Këshillit të Europës foli për programet dhe projektet, të cilat zhvillohen me intensitet të forcuar në shumë sfera shoqërore të veprimit. Ata shprehën mbështetje për prioritetet e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, veçanërisht në lidhje me rritjen e vetëdijes së qytetarëve mbi zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

*27 gusht 2019*

**Agjencia e Zbatimit të Gjuhës priti në takim përfaqësuesit e Forumiit ZFD**

Në zyrat e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesve të saj dhe atyre të Forumit ZFD. Në takim përfaqësuesit e Forumit ZFD prezentuan projektet e realizuara prej tyre, si dhe projektet e tjera të cilat pritet t'i realizojnë.



Agjencia e Zbatimit të Gjuhës shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar me Forumin ZFD në sfera të ndryshme, si në projekte për zbatimin e dygjuhësisë, në organizime të konferencave, seminareve, shkollave verore etj.

*4 shtator 2019*

**Agjencia e Zbatimit të Gjuhës priti përfaqësuesit e Seksionit të Dimensionit Njerëzor të Misionit të OSBE-së në Shkup**

Kryesuesi i këtij seksioni, Alessio Zuccarini, dhe përfaqësuesja Tatjana Temellkoska u pritën sot nga drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, ndërkaq temë bisede ishte puna dhe aktiviteti i kësaj agjencie. Në takim, përfaqësuesit e Dimensionit Njerëzor u njoftuan për aktivitetet e deritanishme të agjencisë, sfidat, pengesat, si dhe planet e idetë për të ardhmen.



Drejtori Sela falënderoi OSBE-në për ndihmën që deri tani ia ka dhënë Maqedonisë së Veriut, duke kërkuar mbështetje dhe bashkëpunim për projekte të sferës së gjuhës dhe bashkëpunimit ndëretnik në Maqedoninë e Veriut. Nga ana tjetër, Zuccarini u shpreh se janë të gatshëm të ofrojnë mbështetjen e tyre, aq sa OSBE-ja ka kapacitete.



Në këtë drejtim, u propozuan mundësi për nënshkrimin e një memorandumi të mirëkuptimit ndërmjet Agjencisë së Zbatimkit ë Gjuhës dhe seksionit përkatës të OSBE-së, përgatitje të grupeve të bashkërendimit të bashkëpunimit në realizimin e projekteve të interesit të përbashkët, mbështetje konkrete nga OSBE-ja edhe për aspektet e funksionimit të agjencisë etj. Palët u pajtuan se e ardhmja e vendit është krijimi i një shoqërie shumetnike, shumëkulturore dhe shumëgjuhësore, e cila do të ecë drejt Bashkimit Europian, si e vetmja rrugë drejt përparimit dhe zhvillimit të vendit.

*6 Shtator 2019*

**Komisioni i Venecies interesohet për Ligjin e Përdorimi të Gjuhëve dhe Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës**

Një delegacion i Komisionit të Venecies qëndroi sot në Shkup, ku vizitoi edhe Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës. Komisioni në fjalë u interesua për Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve në përgjithësi, si dhe për aktivitetet e agjencisë në fjalë, në veçanti.

Me këtë rast, Komisioni i Venecies u prit nga drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, i cili e njoftoi delegacionin për mbarëvajtjen e punëve në këtë agjenci. Komisioni

u njoftua hollësisht për fillimin me punë të agjencisë, sfidat, problemet, si dhe për projektet e planifikuara të realizohen në të ardhmen e afërt.




Delegacioni i Komisionit të Venecies u interesua të dijë më tepër për gjendjen me zbatimin e gjuhës shqipe, si dhe me pengesat apo kundërshtimet e mundshme që mund të shfaqen ndaj procesit në fjalë. U theksua se duhet të vazhdohet ritmi i zbatimit të gjuhës shqipe, si dhe të punohet drejt një Maqedonie Veriore shumetnike, shumëkulturore, shumëgjuhësore, e mbi të gjitha europiane.

*9 shtator 2019*

**Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Agjencia e Zbatimit të Gjuhës do të realizojnë projekte të përbashkëta**

Në kuadër të takimeve ndërinstitucionale, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, vizitoi Institutin Albanologjik të Prishtinës, ku u prit nga kreu i këtij institucioni, Hysen Matoshi, sekretari Sylë Kasumaj dhe albanologu Qemal Murati.

Me këtë rast, drejtori Sela e njoftoi Institutin Albanologjik për organizimin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, punën e deritanishme, sfidat, pengesat dhe planet për të ardhmen.



Në takim palët janë pajtuar që të dy institucionet duhet të bashkëpunojnë dhe se kjo duhet të realizohet nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshjeje konkrete dypalëshe.

Drejtori Sela kërkoi mbështetje nëpërmjet përvojës së Institutit Albanologjik, sidomos në sferën e botimeve, konferencave, seminareve dhe përpilimit të fjalorëve terminologjikë. Njëkohësisht, Sela ftoi kreun e këtij instituti që ta vizitojnë Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës, për ta konkretizuar bashkëpunimin dypalësh.

*11 Shtator 2019*

**Avokati i Popullit mbështet punën e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, realizoi një takim pune me Avokatin e Popullit, Ixhet Memeti. Me këtë rast, Avokati i Popullit shfaqi interesimin e tij rreth ngritjes së AZGJ-së, si dhe çështjet me të cilat është e ngarkuar që të merret.

Drejtori Sela e njoftoi Avokatin e Popullit për punën, aktivitetet, pengesat, si dhe planet e agjencisë për të ardhmen.




Gjithashtu, Avokati i Popullit u njoftua rreth përgatitjes së materialeve të agjencisë, si broshura, udhëzuesi dhe udhërrëfyesi, të cilat janë në përgatitje e sipër. Në takim, Avokati i Popullit ofroi mbështetjen e tij për agjencinë, duke dhënë disa këshilla dhe ide se si të veprohet më tutje. Palët nuk përjashtojnë mundësinë e bashkëpunimit në të ardhmen e afërt me projekte të ndryshme.

*11 Shtator 2019*

**Agjencia e Zbatimit të Gjuhës ofroi mbështetje institucionale për Entin Shtetëror të Statistikës**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, qëndroi në zyrat e Entit Shtetëror të Statistikës (ESHS), ku u takua me drejtorin e këtij enti, Apostoll Simovksi, me zëvendësdrejtorin Zirap Ademi dhe koordinatoren Jasmina Gjorgjieva. Në takim, drejtori i ESHS-së, Simovski njoftoi rreth aspektit të përdorimit të gjuhës shqipe në këtë institucion në lidhje me përkthimin e materialeve të ndryshme dhe formularëve, duke theksuar se ngelet shumë punë për t'u realizuar te formularët elektronikë.



Në anën tjetër, drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, bëri të ditur se vizita ka karakter ndihmës për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, duke ofruar ndihmë konkrete, nëse ESHS-ja ka nevojë. Palët u pajtuan se sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve duhet të tejkalohen, pse jo edhe nëpërmjet bashkëpunimit dypalësh.

*11 Shtator 2019*

**U realizua takimi i dytë me përfaqësuesit e Komisionerit të Lartë të OSBE-së të Pakicave Kombëtare**

Në zyrat e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) u realizua takimi i dytë me përfaqësuesit e Komisionerit të Lartë të OSBE-së të Pakicave Kombëtare. Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, i informoi në lidhje me të arriturat e deritanishme të agjencisë, që nga takimi i parë, pastaj për punësimet e para që do të bëhen nga dita e hënë.




Ai gjithashtu informoi edhe për periudhën e ngelur deri në fund të këtij viti dhe planet e strategjitë që ka kjo agjenci për vitin e ardhshëm. Në takim u fol edhe për sfidat që ka agjencia për funksionimin e plotë, në aspektin e inventarit, stafit që është në kompletim e sipër dhe gjëra të tjera teknike. Përfaqësuesit e OSBE-së u interesuan kryesisht edhe në lidhje me harmonizimin e punës ndërmjet AZGJ-së dhe Inspektoratit të Gjuhës, i cili duhet të themelohet së shpejti.

*13 Shtator 2019*

**Një ekip i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës vizitoi kreun e Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov**

Sot, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, realizoi takim me Petre Shilegovin, kryetar i Qytetit të Shkupit. Me këtë rast, Shilegov u interesua për punët dhe sfidat me të cilat po përballet AZGJ-ja. Pas njoftimit për çështjet rreth funksionimit të agjencisë, drejtori Sela e informoi se qytetarët po ankohen për mungesë formularësh në gjuhën shqipe dhe emërtimin e institucioneve dhe informata të tjera në Qytetin e Shkupit.



Në anën tjetër, Shilegov theksoi se tashmë janë marrë masat dhe se janë angazhuar përkthyes që po merren me aspektet gjuhësore. Sela dhe Shilegov ranë në ujdi që të dyja institucionet të formojnë grupe pune për të shqyrtuar mangësitë e përdorimit të gjuhës shqipe, zgjidhjen e tyre dhe deri ku ka arritur zbatimi i saj.

Palët u zotuan se do të ketë edhe bashkëpunime të mëtutjeshme ndërinstitucionale.

*18 Shtator 2019*

**Agjencia e Zbatimit të Gjuhës dhe Shoqata e Përkthyesve dhe Interpretuesve e Maqedonisë do të bashkëpunojnë në të ardhmen**

Dje u realizua një takim zyrtar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) dhe Shoqatës së Përkthyesve dhe Interpretuesve të Maqedonisë (SHPIM). Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, mirëpriti kryetaren e SHPIM-së, Ognena Nikulski, të cilën e njoftoi me aktivitetet, sfidat, pengesat dhe planet e agjencisë për të ardhmen.



Në anën tjetër, kryetarja Nikulski informoi në lidhje me projektet në të cilat po punon SHPIM-ja, si edhe mundësitë ekzistuese të bashkëpunimit dypalësh.

Krahas aspekteve të bashkëpunimit, Sela dhe Nikulski diskutuan edhe për mundësinë e nënshkrimit të një memorandumi për bashkëpunim, i cili do ta thellonte bashkëveprimin dypalësh në projekte të ndryshme që kanë të bëjnë me përkthimin dhe lekturimin.

*19 Shtator 2019*

**Zbatimi i gjuhës shqipe në Inspektoratin Shtetëror të Punës – shembull që duhet ta ndjekin të gjithë funksionarët**

Zbatimi i gjuhës shqipe në institucionet shtetërore dalëngadalë po bëhet realitet i pranueshëm dhe normal, pa e dëmtuar askend. Kështu, si shembull pozitiv mund të merret Inspektorati Shtetëror i Punës i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili tanimë ka vënë në zbatim të plotë përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe në të gjitha aktet dhe dokumentet.




Duke filluar që nga tabela e emërtimit, e vendosur në hyrje të këtij institucioni, e deri te shkresa më e thjeshtë, të gjitha i ka bërë dhe vazhdon t'i bëjë në dy gjuhë, pra maqedonisht dhe shqip. E gjithë kjo punë është bërë në saje të vullnetit dhe ngulmimit të drejtorit të këtij institucioni, zotit Alajdin Havziut i cili me pedantërinë dhe përkushtimin e tij, në mënyrë plotësisht ligjore, vetëm me dy përkthyes ka arritur ta vërë në përdorim zyrtar gjuhën shqipe.

Mbase ky rast mund të shërbejë si shembull i mirë edhe për të gjithë drejtorët dhe funksionarët e tjerë të cilët ligjin e kanë zbatur pjesërisht ose që nuk e kanë filluar fare për arsye të ndryshme.

*24 Shtator 2019*

**Takim pune ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës dhe Qendrës Nansen Dialog**

Sot, në hapësirat e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) u mbajt takim pune ndërmjet drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela, dhe drejtorit ekzekutiv të Shoqatës së Qytetarëve Qendra Nansen Dialog - Shkup, Veton Zekolli. Me këtë rast, drejtori Sela e informoi bashkëbiseduesin për punën e deritanishme, aktivitetet e planifikuara dhe sfidat me të cilat përballet AZGJ-ja në zbatimin e kompetencave konform ligjit.



Nga ana tjetër, Zekolli e informoi bashkëbiseduesin për aktivitetet vijuese të shoqatës, përgatitjen e publikimit dygjuhësh (udhëzues) maqedonisht dhe shqip që pritet të publikohet deri në fund të vitit 2019, si edhe për punën e qendrës trajnuese të aftësimit të kuadrit pedagogjik sipas modelit Nansen për arsim të integruar.

Palët shprehën gatishmëri për vazhdimin e mëtutjeshëm dhe avancimin e bashkëpunimit dypalësh në drejtim të shkëmbimit të përvojave, ndihmës teknike, si dhe punës në projekte të interesit të përbashkët.

*24 Shtator 2019*

**Vizitë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Në suaza të vizitave të zakonshme për t'u ofruar mbështetje institucioneve lidhur me zbatimin e obligimeve që dalin nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, gjatë ditës së sotme drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, së bashku me bashkëpunëtorët e tij e vizitoi Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku vërejti se që në hyrje të këtij institucioni tabela ende qëndronte vetëm në një gjuhë.



Në këtë takim u prit nga drejtoresha e këtij institucioni, Biljana Jovanovska dhe zëvendësdrejtori i sapoemëruar, Bekim Murati, me bashkëpunëtorët e tyre dhe u diskutua për vonesat që janë bërë në fazën e parë të zbatimit ligjor, me theks të veçantë u fol për tabelat, memorandumet, logot dhe ueb faqet. Drejtori Ylber Sela me bashkëpunëtorët e tij ofroi mbështetje të plotë për t'i tejkaluar këto vonesa dhe ranë dakord që në të ardhmen të dy institucionet të bashkëpunojnë dhe të bëjnë parapërgatitjen për fazën e dytë, në mënyrë që ky institucion t'i zbatojë obligimet që dalin nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve.

*26 Shtator 2019*

**Agjencia e Zbatimit të Gjuhës promovoi broshurën me informacione për të drejtat gjuhësore të qytetarëve në RMV**

Me rastin e 26 Shtatorit – Ditës Europiane të Gjuhëve, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) mbajti një aktivitet ku para disa pjesëtarëve të përfaqësive diplomatike-konsullare, përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, shoqatave të qytetarëve dhe medieve, promovoi broshurën: ***Informacione mbi të drejtat gjuhësore të qytetarëve në Republikën e Maqedonië së Veriut .***



Me këtë rast, para të pranishmëve broshura u prezantua nga drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, dhe ekipi i agjencisë. Drejtori Sela mbajti fjalë hyrëse, duke theksuar rëndësinë dhe simbolikën e datës së sotme kur festohet dhe shënohet shumëgjuhësia dhe veçantia gjuhësore rreth Europës. Broshura është publikim i parë zyrtar i AZGJ-së, që është përgatitur në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze.

Broshura ka për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin te qytetarët për të drejtat gjuhësore dhe të drejtën e shfrytëzimit të cilësdo gjuhë zyrtare gjatë realizimit të të drejtave të tyre në procedura para organeve të pushtetit, në nivel qendror

dhe lokal. Në fund të aktivitetit, drejtori Sela u përgjigj në pyetjet e gazetarëve që ndërlidheshin me aktivitetet e AZGJ-së dhe zbatimin e kompentecave ligjore të saj.

*1 Tetor 2019*

**Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e shënoi Ditën Ndërkombëtare të Përkthimit**

Ditën Botërore të Përkthimit Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e shënoi me një panel me temë "Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut", ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme. Panelin e hapi drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, i cili u dëshiroi mirëseardhje pjesëmarrësve duke i njoftuar me preokupimet dhe rrjedhat e punës në këtë institucion.



Me kumtesa u paraqitën Ajten Hajdari - Qamili nga Universiteti "Shën Cirili dhe Metodi", Edlira Bushati nga Universiteti "Luigj Gurakuqi" i Shkodrës, Izer Maksuti nga Universiteti i Prizrenit, Qemal Murati nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, Besa Dërndar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ognena Nikulski nga Shoqata e Përkthyesve dhe

Interpretuesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Asllan Hamiti nga Universiteti “Shën Cirili dhe Metodi”, Zeqirja Ibrahimi nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, Berton Sulejmani nga Universiteti i Tetovës, Mustafa Ibrahimi nga Universiteti “Nënë Tereza”, Marjan Patlixhankovski dhe Ahmet Selmani nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës.




Pjesëmarrësit në fjalë kryesisht u përqendruan në sfidat e përkthimit në përgjithësi, por në veçanti në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me këtë rast u vunë në dukje shumë dukuri, probleme e vështirësi që shfaqen gjatë përkthimit, por edhe zbatimit të gjuhës standarde shqipe.

Si kërkesë doli që të krijohen rrethana për ngritjen e vetëdijes sa i përket kësaj çështjeje, të rritet kujdesi për ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës, të hartohen fjalorët e nevojshëm terminologjikë me të cilët do të shërbehen përkthyesit, të zgjidhet kuadri më i mirë nëpër institucione, të rritet cilësia e arsimit etj.

Duke marrë parasysh cilësinë e dobët të arsimit në përgjithësi, pjesëmarrësit e panelit theksuan se duhet të bëhet një përzgjedhje shumë rigoroze e përkthyesve profesionalë të cilët do të përfshihen në fushën e

përkthimit dhe në këtë mënyrë të ruhet gjuha shqipe sipas natyrës së saj. Natyrisht, në këtë kontekst të gjithë pjesëmarrësit i dhanë mbështjetje të plotë Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës duke theksuar se është institucioni i vetëm i këtij lloji që kujdeset për zbatimin e gjuhës standarde shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Sipas tyre, projektet e ndërmarra nga kjo agjenci do të ndikojnë dukshëm në përmirësimin e gjendjes së gjuhës shqipe, por njëkohësisht edhe do t'i sensibilizojnë të gjitha institucionet arsimore për t'i kushtuar vëmendje dhe për të dhënë ndihmesën e tyre në aspektin e zbatimit të gjuhës shqipe.

*2 Tetor 2019*

**U mbajt takimi i dytë me Lamberto Zanierin, Komisari i Lartë i Pakicave Kombëtare i OSBE-së**

Ylber Sela, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), ishte nikoqir i delegacionit të udhëhequr nga Komisari i Lartë i Pakicave Kombëtare i OSBE-së, Lamberto Zanieri. Në takim, drejtori Sela shprehi kënaqësinë e vizitës së komisarit Zanieri dhe falënderoi atë për mundësinë e takimit në selinë e AZGJ-së.



Drejtori Sela e informoi bashkëbiseduesin për punën e deritanishme, nevojën për aranzhim infrastrukturor, pajisje teknike dhe ekipim me kadër të AZGJ-së dhe, në këtë kontekst, u shpreh i hapur për bashkëpunim me komisarin në drejtim të sigurimit të ndihmës teknike dhe punës në projekte të përbashkëta të interesit të përbashkët.

Komisari Zanieri theksoi bashkëpunimin e shkëlqyer të deritanishëm dhe komunikimin e Misionit të OSBE-së në Shkup dhe ambasadorit Klement Koja me drejtorin Sela, si dhe theksoi dëshirën e tij për vazhdimin e mëtutjeshëm të dialogut të ndërsjellë me AZGJ-në në drejtim të realizimit të zotimeve të përbashkëta dhe sigurimit të ndihmës teknike për forcimin e kapaciteteve instituiconale të AZGJ-së.

*Shkup, 3 tetor 2019*

**Vizitë pune në Gazetën Zyrtare**

Në kuadër të vizitave të punës që po i bën Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, një takim të ngjashëm e zhvilloi edhe me përfaqësuesit e Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, me bashkëpunëtorët e tij u prit nga drejtori i Gazetës Zyrtare, Martin Kostovski dhe bashkëpunëtorët e tij. Me këtë rast, drejtori Sela e njoftoi homologun e tij lidhur me aktivitetet që po i zhvillon institucioni i tij për të parë nga afër gjendjen reale në fazën e parë lidhur me zbatimin e dygjuhësisë në praktikë, veçmas duke u përqendruar në lekturimin e Gazetës Zyrtare të cilën duhet ta bëjë Agjencia e Zbatimit të Gjuhës.




Nga ana tjetër, po ashtu, edhe drejtori i Gazetës Zyrtare, Martin Kostovski, e informoi homologun e tij lidhur me obligimet e tij në këtë drejtim, duke folur për vështirësitë dhe dilemat që shfaqen gjatë punës së përkthimit, lekturimit dhe botimit. Në fund, të dy drejtorët ranë dakord që të gjitha këto gjëra duhet të ndjekin një dinamikë të qartë, për të mos u shfaqur asnjë vështirësi e pengësë.

Në këtë aspekt ata theksuan faktin se duhet të shihen dhe shfrytëzohen përvojat e gjertanishme në Kosovë dhe Bosnjë e Hercegoninë, si një model të mundshëm për ta zbatuar edhe te ne. Të dy shprehën gatishmëri për të vazhduar takimet dhe bashkëpunimi edhe në të ardhmen për sa i përket zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhës, veçmas nga muaji janar kur duhet të fillojë edhe faza e dytë e zbatimit të tij.

*7 Tetor 2019*

**Takim pune me zëvendësdrejtorin e Shtëpisë Ndëshkuese-Përmirësuese**

Sot në zyrat e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) në vizitë pune ishte zëvendësdrejtori i Shtëpisë Ndëshkuese-Përmirësuese, Sadush Arifi, ku në takim me drejtorin e AZGJ-së, Ylber Sela, diskutuan për obligimet që dalin nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve.



Me këtë rast, Sadush Arifi e njoftoi drejtorin Sela mbi sfidat dhe pengesat e zbatimit të këtij ligji në institucionet ndëshkuese-përmirësuese.

Bashkëbiseduesit ranë dakord të mbajnë takime të tilla edhe në të ardhmen, të cilat do ta thellojnë bashkëpunimin e të dyja institucioneve, në drejtim të zbatimit të obligimeve që burojnë nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve

*7 Tetor 2019*

**Përfaqësuesit e Agjencisë së Investimeve të Huaja vizituan Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës**

Përfaqësuesit e Agjencisë së Investimeve të Huaja dhe të Promovimit të Eksportit (AIHPE) realizuan një takim informues me Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGJ). Me këtë rast, Arben Vila, drejtor i AIHPE-së, informoi rreth aktiviteteve që kjo agjenci i ka ndërmarrë për të përmbyllur fazën e parë të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, që përfshin ndryshimin e vulave, logove, uebfaqes dhe tabelave.



Ai bëri të ditur se agjencia të cilën e drejton, tashmë ka filluar me zbatimin edhe të fazës së dytë të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, që do të thotë se të gjitha aktet dhe dokumentet që dalin nga kjo agjenci përpilohen në dy gjuhë.

Nga ana tjetër, drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, shprehi mirënjohjen personale dhe të agjencisë në lidhje me ecurinë e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve nga Agjencia e Investimeve të Huaja dhe e Promovimit të Eksportit, duke theksuar se shembullin e kësaj agjencie duhet ta ndjekin edhe institucionet e tjera.

*9 Tetor 2019*

**Vizitë pune në Drejtorinë e Ekzekutimit të Sanksioneve**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, në kuadër të aktiviteteve të rregullta të punës, realizoi një vizitë në Drejtorinë e Ekzekutimit të Sanksioneve (DES), ku pati një takim pune me Jovica Stojanoviqin, drejtor i DES-së.

Në takim, drejtori Sela me bashkëbiseduesin e tij shkëmbyen qëndrime rreth nivelit të deritanishëm të realizimit të obligimeve që burojnë nga dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, nga ana e DES-së, si edhe në

shtëpitë ndëshkuese-korrektuese në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Palët u pajtuan se është i nevojshëm dinamizim i realizimit të obligimeve dhe se AZGJ-ja me kapacitetet e saj mbetet e hapur për bashkëpunim dhe mbështetje të DES-së për të gjitha çështjet që burojnë nga zbatimi i zgjidhjes së re ligjore të përdorimit të gjuhëve.

Ky takim është në të mirë të përshpejtimit të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve nga ana e institucionit të lartpërmendur ku ka ngecje në këtë drejtim.

*9 Tetor 2019*

**Vizitë pune në zyrat e Regjistrit Qendror**

Sot në zyrën e Regjistrit Qendror (RQ) drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, realizoi takim pune me Marija Boshkovska-Jankovskin, drejtoreshë e RQ-së.

Drejtori Sela theksoi se takimi është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse RQ-ja është një nga institucionet kyç ku janë të nevojshme përpjekje të konsiderueshme për mundësimin e qasjes së plotë në shërbime për personat fizikë dhe juridikë në gjuhët zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Në takim, drejtoresha Boshnjakovska-Jankovski theksoi se RQ-ja po punon drejt azhurnimit të zgjidhjes aplikative softuerike që do të mundësojë qasje për qytetarët dhe subjektet afariste te shërbimet shfrytëzuese në gjuhët zyrtare, si dhe në procedurë është edhe zbatimi i obligimeve të tjera që burojnë nga zbatimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Palët shprehën interes për bashkëpunim të mëtutjeshëm dhe pritshmëri që dialogu konstruktiv ndërmjet dy institucioneve do të vazhdojë të përparojë në të ardhmen. Ky takim është në të mirë të përshpejtimit të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve nga ana e institucionit të lartpërmendur ku ka ngecje në këtë drejtim.

*18 Tetor 2019*

**Delegacion i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës vizitoi Universitetin e Shkodrës**

Më 14 tetor, Universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës e vizitoi një delegacion i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, i kryesuar nga drejtori i saj, Ylber Sela. Delegacioni në fjalë u prit nga rektori i këtij universiteti, Adem Bekteshi,

dekania e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Mimoza Priku, drejtori i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Artan Haxhi dhe Edlira Bushati, shefja e Katedrës së Gjuhës Gjermane në këtë universitet.




Rektori Bekteshi, duke uruar mirëseardhje, theksoi se ligji për zyrtarizimin e gjuhës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe formimi i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës ka qenë një lajm i mirë edhe për ne në Shqipëri.

Prandaj, zgjedhja për ta vizituar Universitetin e Shkodrës dhe për të kërkuar mbështetje prej nesh, na ka gëzuar pa masë, shtoi ai. Më tej, ai foli për studimet albanologjike në këtë universitet, bashkëpunimi me qendrat e ndryshme etj. Ai u shpreh i gatshëm për çdo formë bashkëpunimi dhe kontributi për sa i përket gjuhës shqipe, premtoi se ndihma do të jetë e pakursyer, sepse gjuha është detyrë e përbashkët.



Propozim tjetër i rektorit ishte që Departamenti i Gjuhës i këtij universiteti të bëjë një vizitë në Shkup për t'u njohur nga afër me institucionin e AZGJ-së.

Nga ana tjetër, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, i njoftoi nikoqirët me punën dhe aktivitet e agjencisë. Ai tha se ky takim kishte vlerë të madhe për ta dhe jo rastësisht është zgjedhur Shkodra për shumë arsye. Qëllimi kryesor është njohja e ndërsjellë, gjetja e bashkëpunëtorëve për projektet tona, për seminare, hartimin e fjalorëve, punëtori të ndryshme etj.

*18 Tetor 2019*

**Ministri i Diasporës, Pandeli Majko priti një delegacion të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës**

Ministri i Shtetit për Diasporën i Republikës së Shqipërisë, Pandeli Majko, priti në zyrën e tij në Tiranë një delagacion të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, të kryesuar nga drejtori i saj, Ylber Sela. Gjatë këtij takimi drejtori Ylber Sela, e informoi ministrin Pandeli Majko lidhur me punën, angazhimet, sfidat dhe projektet që po bën ky institucion.

Ministri Pandeli Majko e uroi drejtorin Ylber Sela për detyrën, punën dhe angazhimin që po bën në aspektin e zbatimit të ligjit të miratuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili i ka hapur rrugën gjuhës shqipe për të qenë në përdorim zyrtar. Ai po ashtu shprehu gatishmëri për të ndihmuar në situata të nevojshme.




*18 Tetor 2019*

**Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e vizitoi Akademinë e Shkencave të Shqipërisë**

Gjatë vizitave në Shqipëri, delegacioni i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, i kryesuar nga drejtori Ylber Sela e vizitoi edhe Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, ku u prit nga zëvendëskryetari i saj, akademiku Vasil Tole, me bashkëpunëtorët e tij. Në këtë takim drejtori Sela e informoi atë për punën që ka bërë dhe që po bën Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, veçmas duke theksuar nevojën e bashkëpunimit dhe ndihmës.

Akademiku Vasil Tole, tregoi gatishmëri për të bashkëpunuar me këtë institucion, duke ofruar ndihmë shkencore dhe profesionale, për sa i përket hartimit të fjalorëve terminologjikë, si dhe për gjëra të tjera të nevojshme. Me këtë rast ai u zotua se të gjitha botimet e Akademisë së Shkencave do t'i dhurohen Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës.





*18 Tetor 2019*

**Delegacioni i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës e vizitoi Akademinë e Studimeve Albanologjike në Tiranë**

Në suaza të vizitave të shumta në Republikën e Shqipërisë, delegacioni i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, i kryesuar nga drejtori Ylber Sela, e vizitoi edhe Akademinë e Studimeve Albanologjike. Delegacioni në fjalë u prit nga kryetari i kësaj akademie, Marenglen Verli dhe bashkëpunëtorët e tij.

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela e njoftoi nikoqirin lidhur me punën dhe angazhimet që po bën kjo agjenci në zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Po ashtu ai theksoi se nevojitet njohje dhe bashkëpunim ndërinstitucional.



Kryetari i kësaj akademie Marenglen Verli, theksoi se ndihma e tyre do të jetë e pakursyer në aspektin e hartimit të fjalorëve terminologjikë, si dhe premtoi se agjencisë do t'i jepen të gjithë fjalorët në formatin elektronik etj.

Po ashtu, ai u zotua se Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës për nevojat e saj do t'i dhurohen nga disa kopje të botimeve të Akademisë së Studimeve Albanologjike.

*18 Tetor 2019*

**Vizitë e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës në Fakultetin e Histori-Filologjisë në Tiranë**

Njëra nga vizitat e delegacionit të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, të kryesuar nga drejtori i saj Ylber Sela, ishte edhe ajo në Fakultetin e Histori-Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Delegacioni u prit nga dekani i këtij fakulteti, Sabri Laçi me bashkëpunëtorët e tij.




Drejtori Ylber Sela e njoftoi atë lidhur me sfidat, angazhimet dhe projektet e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës gjatë kësaj periudhe.

Po ashtu, edhe dekani Laçi e uroi për punën që po bën kjo agjenci, duke shprehur gatishmëri për ndihmë profesionale në aspektin e unifikimit të terminologjisë, përpilimit të fjalorëve etj.

*18 Tetor 2019*

**Delegacioni i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës vizitoi Qendrën e Botimeve Zyrtare**

Krahas shumë vizitave të tjera, delegacioni i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës i kryesuar nga drejtori i saj, Ylber Sela e vizitoi edhe Qendrën e Botimeve Zyrtare në Tiranë. Ai i njoftoi nikoqirët lidhur me aktivitetet dhe projektet që ka zhvilluar kjo agjenci në periudhën e gjertanishme.

Pastaj nikoqirët folën për punën e tyre në botimin e Fletores Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, për mënyrën se si realizohet botimi i akteve dhe dokumenteve zyrtare, redaktimin juridik dhe gjuhësor të tyre etj.




Ata treguan gatishmëri për ta ndihmuar Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës në aspektin e trajnimit dhe këshillimit.

*25 Tetor 2019*

**Agjencia e Zbatimit të Gjuhës dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi**

Sot, Institutin e Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup e vizitoi një delegacion i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, i udhëhequr nga drejtori Ylber Sela.

Me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional, ai bashkë me drejtorin e Institutit, Skender Asani, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, për mbështetjen e ndërsjellë profesionale, veçanërisht në fushën e kujdesit për gjuhën e unifikuar shqipe.




Me këtë marrëveshje parashihet bashkëpunimi në fusha me interes të përbashkët, siç është këmbimi i resurseve, kuadrove, literaturës dhe përvojave për zbatimin e drejtë të shqipes në Republikën e Maqedonisë së Veriut; sensibilizimi i opinionit më të gjerë për nevojën e kultivimit dhe ruajtjes së trashëgimisë gjuhësore shqipe si pasuri kombëtare; promovimi dhe kujdesi për gjuhën e unifikuar shqipe; studimi i mundësive për mbështetjen e projekteve të ndërsjella mes ITSHKSH-së dhe Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës për realizimin e projekteve të ndryshme që e përmbushin synimin e këtij memorandumi; stimulimi i projekteve të përbashkëta etj.

Ky memorandum është në vazhdën e përpjekjeve të këtye dy institucioneve për zgjerimin e kapaciteteve dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit në sferën e ruajtjes dhe kultivimit të gjuhës shqipe.




*29 Tetor 2019*

**Drejtori Sela në takim me kryetarin e Këshillit Gjyqësor, Zdravev**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, sot realizoi një takim pune me kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kiro Zdravev, për t'u njohur nga afër me gatishmërinë e këtij institucioni për të zbatuar gjuhën shqipe në procedurat gjyqësore.




Gjatë këtij takimi u fol për nevojën e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për t'i tejkaluar vështirësitë që mund të hasen gjatë punës së Këshillit Gjyqësor. Kryetari Zdravev me këtë rast tha se Këshilli Gjyqësor tashmë ka filluar fazën e parë të zbatimit të gjuhës ku përfshihen tabelat, vulat, memorandumet, logot, duke theksuar nevojën e një kuadri më profesional përkthyesish dhe të trajnuar mirë për të ndjekur punën e këshillit.

Drejtori Sela, në vazhdën e takimeve të këtilla që realizon me institucione për të ofruar mbështetje të parezervë për zbatimin e drejtë të gjuhës shqipe, tha se agjencia është e gatshme të ofrojë çfarëdolloj ndihme që kërkohet nga ana e këtij institucioni në mënyrë që secili të realizojë obligimet që burojnë nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve.

*30 Tetor 2019*

**Delegacion i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës në takim me kreun e KSHZ-së**

Duke marrë parasysh paralajmërimin e Qeverisë së RMV-së për një cikël të ri zgjedhjesh në prill të vitit të ardhshëm, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, sot realizoi një takim pune me kreun e KSHZ-së për të ofruar mbështetetjen e tij në zbatimin sa më të drejtë të gjuhës shqipe në materialet që do të duhet të përgatiten për mbarëvajtjen e këtij procesi.




Kryetari i KSHZ-së, Oliver Derkovski, i shoqëruar nga nënkryetarja Ditmire Shehu dhe anëtarët e tjerë të KSHZ-së, shprehu kënaqësinë nga interesi i drejtorit Sela për t'i ndihmuar institucionet e vendit në zbatimin e drejtë të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve duke e njohur atë se KSHZ-ja sigurisht do të ketë nevojë për një kuadër profesional përkthyesish për shkak të kompleksitetit të materialeve dhe se do të jetë i gatshëm t'i respektojë të gjitha dispozitat ligjore që i parasheh Ligji i Përdorimit të Gjuhëve.

*5 Nëntor 2019*

**Drejtori Sela zhvilloi një takim pune në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurat Administrative dhe në Procedurat e Marrëdhënieve të Punës në Shkallën e Dytë**

Sot, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, realizoi një takim pune me Danica Çadievën, kryetare e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurat Administrative dhe në Procedurat e Marrëdhënieve të Punë në Shkallën e Dytë.



Në takim, drejtori Sela u njoh me gjendjen në komisionin shtetëror lidhur me zbatimin e obligimeve që dalin nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve në procedurat për të cilat është kompetent ky komision.

Kryetarja e komisionit shtetëror, Çadieva vuri në dukje se ka mungesë të burimeve njerëzore dhe hapësinore për zbatimin efikas dhe realizimin e të drejtave të qytetarëve që paraqiten si palë në procedurat e apelit para komisionit, të cilët flasin në gjuhën shqipe dhe se janë të nevojshëm përkthyes profesionistë dhe lektorë, të cilët janë njohës të mirë të terminologjisë juridike për shkak të kompleksitetit dhe specifikave të lëndëve.

Drejtori Sela shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar me komisionin shtetëror dhe konstatoi se janë të nevojshëm hapa seriozë drejt përmbushjes me kohë të detyrimeve ligjore, pavarësisht sfidave të brendshme brenda komisionit shtetëror.

*6 Nëntor 2019*

**AZGJ-ja dhe ASHAM-ja së shpejti do të nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, sot u takua me kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut – akademikun Taki Fiti për të parë nga afër nëse ky institucion i lartë shkencor ka filluar zbatimin e fazës së parë të obligimeve që burojnë nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve. Gjatë takimit u vërejt se ASHAM-ja vonon në zbatimin e fazës së parë nga obligimet që dalin nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, me ç'rast akademiku Fiti shfaqi gatishmëri që, pas ndryshimit të Ligjit të ASHAM-së, do të jenë të gatshëm të bëjnë ndryshimet e nevojshme për të zbatuar procedurat ashtu siç i parashikon ligji.



Drejtori Sela me këtë rast tha se zbatimi i gjuhës shqipe nga ana e këtij institucioni të lartë shkencor, siç është ASHAM-ja, do të ishte shembull dhe motiv shtesë edhe për institucionet e tjera shkencore dhe kulturore në vend duke pasur parasysh gjuhën e tjetrit si vlerë dhe jo si hendikep.

Kryetari i ASHAM-së, akademiku Taki Fiti, falënderoi drejtorin Sela për këto takime të rëndësishme që i realizon nëpër institucione të vendit, duke

ofruar mbështetje dhe ndihmë për zbatimin zyrtar të gjuhës shqipe, ashtu siç e parashikon edhe vetë Ligji i Përdorimit të Gjuhëve.




ASHAM-ja, u shpreh akademiku Taki Fiti, në kryesinë e saj numëron edhe katër akademikë të lartë shkencorë me kombësi shqiptare dhe se domosdoshmërisht zbatimi i gjuhës shqipe në punën e tyre do të jetë e pashmangshme, duke mos anashkaluar faktin se do të duhet të angazhohet kuadër profesional për të ndjekur punën e këtij institucioni.

*11 Nëntor 2019*

**Përfaqësuesja e Qendrës së Botimeve Zyrtare të Shqipërisë po qëndron në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës**

Vizita e paradokohshme e përfaqësuesve të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës në Tiranë po jep rezultatet e para të bashkëpunimit. Kështu, sot në këtë institucion qëndroi dr. Jorina Kryeziu-Shkreta, përfaqësuese e fushës gjuhësore e Qendrës së Botimeve Zyrtare të Shqipërisë, e cila do të qëndrojë me shërbim për tri ditë.




Në takimin e sotëm Jorina Kryeziu-Shkreta u njoftua me punën e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, nga ana e drejtorit Ylber Sela. Pastaj, ajo paraqiti përvojën e saj para përkthyesve të AZGJ-së, duke u ndalur konkretisht në mëdyshjet dhe vështirësitë që dalin gjatë punës së vijueshme.

Si domosdoshmëri për t'i tejkaluar të gjitha këto, u theksua nevoja e krahasimit të akteve të përkthyera me tekstin origjinal, ose ndryshe konfrontimin fjalë për fjalë, siç quhet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Po ashtu, u zhvillua edhe një bisedë dhe shkëmbim përvojash ndërmjet zonjës Kryeziu-Shkreta dhe përkthyesve të agjencisë, për çështje të ndryshme lidhur me aspektin tekniko-profesional e gjuhësor.

*11 Nëntor 2019*

**Ligjëratë e profesorit Zejneli para të punësuarve të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës**

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës në Shkup mbajti një ligjëratë profesori Xhelal Zejneli. Para të pranishmëve ai foli për përvojën e tij si

përkthyes shumëvjeçar duke e paraqitur si një model të mundshëm për ta zbatuar edhe në këtë institucion të sapoformuar.



Veçanërisht u përqendrua në hierarkinë e punës së përkthimit, si një proces i domosdoshëm për të arritur te një cilësi sa më e lartë e tekstit të përkthyer. Ai theksoi rëndësinë e përkthimeve profesionale të cilat kanë nevojë për më shumë kujdes dhe seriozitet.

Po ashtu, profesori Zejneli i dha edhe disa këshilla dhe sugjerime të cilat do të mund të zbatohen në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës dhe do të ishin në shërbim të punëtorëve në këtë institucion.

*12 Nëntor 2019*

**Përfaqësuesja e Misionit të OSBE-së në Shkup për vizitë pune në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, realizoi një takim pune me Tatijana Temellkoskën, përfaqësuese e Misionit të OSBE-së në Shkup. Takimi i sotëm ishte vazhdim i dialogut dhe bashkëpunimit të shkëlqyer ndërmjet AZGJ-së dhe OSBE-së, i vendosur që nga themelimi i agjencisë.

Në takim, drejtori Sela e informoi bashkëbiseduesen e tij me projektet e planifikuara si pjesë e prioriteteve strategjike të AZGJ-ës dhe kërkoi mbështetje dhe specifikim të modaliteteve për bashkëpunim me Misionin e OSBE-së, për projekte që synojnë forcimin e konceptit të shtetit shumetnik, promovimin e dialogut dhe bashkëjetesës nëpërmjet zbatimit të programeve trajnuese për përkthyesit dhe lektorët, si dhe fushata për të promovuar përfitimet nga mësimi i më shumë gjuhëve që na mundësojnë shkëmbimin e vlerave të përbashkëta të tolerancës që nga mosha e hershme apo që në ciklin arsimor.



Përfaqësuesja e OSBE-së, Temellkoska, informoi rreth aktiviteteve dhe kontributit të OSBE-së në hartimin e strategjisë nacionale për zhvillimin e konceptit të një shoqërie dhe ndërkulturalizmit, duke theksuar rëndësinë dhe rolin e AZGJ-së në procesin e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave gjuhësore të qytetarëve, si dhe mbështetjen e institucioneve të sektorit publik në zbatimin e detyrimeve ligjore për përdorimin e gjuhëve.

Në këtë kontekst, të dyja palët ranë dakord se ka akoma procese dhe politika të vjetra në shoqëri që shpiejnë në paragjykime, përçarje dhe jotolerancë, të cilat nuk kontribuojnë në forcimin e konceptit qytetar të një shoqërie moderne demokratike të qytetarëve të barabartë dhe se do të nevojitet

më shumë kohë, përpjekje, por dhe aktivitete të përbashkëta që do të rezultojnë në ndërgjegjësimin e shoqërisë për përfitimet që ofron një koncept i tillë.

*14 Nëntor 2019*

**Agjencia e Zbatimit të Gjuhës – pjesë e aktiviteteve për Ditën e Alfabetit**

Në suaza të bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës dhe Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve sot në Manastir filluan aktivitetet për shënimin e 111-vjetorit të Ditës së Alfabetit të Gjuhës Shqipe.




Në këtë aktivitet morën pjesë funksionarë politikë, dashamirës të kulturës etj. Para të pranishmëve foli drejtori i ITSHKSH-së në Shkup – dr. Skender Asani, zëvendëskryeministri Sadulla Duraku, pasardhësi i familjes së Hasan Prishtinës – Mehmet Prishtina, drejtori i Muzeut të Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir – Nuer Arsllani.

Po ashtu, fjalë përshëndetëse mbajti edhe drejtori i AZGJ-së, dr. Ylber Sela, i cili, në mes të tjerash, tha: "Gjuha njihet si një nga karakteristikat

themelore të një identiteti etnik të një populli. Në vitin 1908 u unifikua alfabeti, kurse tash kemi nisur të unifikojmë terminologjinë e fushave të ndryshme."



Me këtë rast, u promovua edhe libri "Lëvizja protestante te shqiptarët" e autorit Dejvid Hosaflluk. Fjalë rasti për librin kishte dr. Jorina Kryeziu-Shkreta, Ledio Hala dhe Bertina Salliu.

Pas tyre, foli edhe vetë autori i librit, i cili u përqendrua në historikun e lëvizjes protestante te shqiptarët, veçanërisht për kontributin e tyre në Manastir, ku u mbajt Kongresi i Alfabetit.

*18 Nëntor 2019*

**Drejtori i AZGJ-së Ylber Sela - në promovimin e librit për Remzi Nesimin**

Në vazhdën e aktiviteteve në kuadër të manifestimit kulturoro-shkencor për shënimin e 111-vjetorit të Kongresit të Manastirit sot u promovua libri i Remzi Nesimit "Për gjuhën shqipe" dhe vëllimi 24 i revistës "Scupi", ku janë botuar punimet e sesionit shkencor me titull "Kontributi i profesorit Remzi

Nesimi për gjuhën shqipe dhe gjuhësinë shqiptare". Në këtë manifestim mori pjesë edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela.

Në praninë e familjarëve e kolegëve të Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare të Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi", aty ku për shumë vjet punoi profesori Remzi Nesimi, u fol shumë për kontributin dhe veprën e tij me të cilën la gjurmë të thella në gjuhësinë shqiptare.



Fjalë rasti para të pranishmëve mbajti profesori dr. Avzi Mustafa, gjuhëtarët dr. Qemal Murati e dr. Hidajete Azizi, ashtu si edhe redaktori përgjegjës – dr. Zeqirija Ibrahimi. Me këtë rast ata theksuan se profesor Remziu ishte personalitet i shquar i botës intelektuale shqiptare, i cili ka dhënë kontribut të çmuar në shkencat filologjike, në fushën e dialektologjisë duke promovuar pasuritë shpirtërore e gjuhësore dhe vlerat e kulturës shqiptare në përgjithësi.

*20 Nëntor 2019*

**Ambasadori i Finlandës për vizitë në AZGJ**

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, priti në zyrën e tij Kimo Lahdevirtën, ambasadorin jorezident të Republikës së Finlandës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në takim, drejtori Sela e përshëndeti vizitën e ambasadorit Lahdevirta në AZGJ si përfaqësues i një vendi me traditë dhe përvojë të madhe në zbatimin e konceptit qytetar të shumëgjuhësisë, duke pasur parasysh se finlandishtja dhe suedishtja janë gjuhë zyrtare në Republikën e Finlandës.



Njëherazi, drejtori Sela e informoi ambasadorin Lahdevirta për punën e deritashme të AZGJ-së, aktivitetet e planifikuara për vitin 2020 si dhe për sfidat me të cilat ballafaqohet AZGJ-ja në aspektin e nevojës për plotësimin e ekipit me kuadër dhe në aspektin teknik për arritje të kapaciteteve të plota operative të institucionit.

Ambasadori Lahdevirta e vlerësoi si tejet pozitive dhe të vlefshme vizitën e tij në AZGJ me ç'rast i paraqiti përvojat e veta nga modeli finlandez rreth zbatimit të përdorimit të gjuhëve zyrtare, duke shprehur gatishmërinë e tij për

sigurimin e kontakteve relevante nga pala finlandeze për realizimin e vizitave dypalëshe në nivel ekspertësh. Të dyja palët u angazhuan për vazhdimin e dialogut dhe shprehën gatishmëri për inicimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët.

*21 Nëntor 2019*

**Drejtori Sela në takim pune në Gjykatën Kushtetuese**

Drejtori i AZGj-së, Ylber Sela, sot realizoi një takim pune në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ç'rast u takua me Sali Muratin, kryetar i Gjykatës Kushtetuese dhe Aleksandar Lazovin, sekretar i përgjithshëm i gjykatës.

Drejtori Sela e uroi z. Muratin për funksionin e tij të ri, duke i dëshiruar shëndet dhe sukses në kryerjen e funksionit me përgjegjësi të lartë.



Njëherazi, ai e informoi bashkëbiseduesin për vështrimet dhe analizat rreth zbatimit të deritashëm të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve dhe për nevojën e

zbatimit konsekuent të ligjit nga të gjithë faktorët, duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në nivel ndërinstitucional.

Kryetari Murati shprehu kënaqësinë e tij nga takimi me drejtorin Sela duke ofruar njëherazi edhe mbështetje ndaj punës së AZGj-së.

Me këtë rast ai e informoi Selën rreth aktiviteteve të Gjykatës Kushtetuese që planifikohen të ndërmerren gjatë mandatit të tij. Gjithashtu përmendi edhe gjendjen jo të favorshme me plotësimin e ekipit të shërbimit profesional, si dhe nevojën për përforcimin e kapaciteteve profesionale të gjykatës me angazhimin e personave kompetentë nga komunitetet joshumicë, duke përfshirë edhe përkthyesit dhe lektorët.

Gjatë këtij takimi, të dy palët e riafirmuan nevojën për forcimin e bashkëpunimit, duke pranuar rëndësinë që ka stimulimi i një ambienti social në respektimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të çdo qytetari, si dhe në promovimin, ruajtjen dhe përforcimin e të drejtës së qytetarëve për t'i përdorur gjuhët zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

*21 Nëntor 2019*

**Agjencia e Zbatimit të Gjuhës nënshkroi memorandum bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë**

Sot në Shkup, Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës e vizitoi një delegacion i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i udhëhequr nga kryetari i saj – Skënder Gjinushi. Në përbërje të këtij delegacioni ishin akademik Shaban Sinani, akademik Gjovalin Shkurtaj si dhe Albana Velianj, përgjegjëse në Sektorin e botimeve shkencore dhe bibliotekës shkencore, i cili shoqërohej nga ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Shkup, Fatos Reka. Delegacioni u prit nga drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, si dhe nga bashkëpunëtorët e tij.




Gjatë këtij takimi, drejtori Sela e njoftoi delegacionin e sipërpërmendur lidhur me punën dhe veprimtaritë që janë duke u zhvilluar në këtë institucion. Për rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve, me interes për gjuhën shqipe si vlerë e përbashkët, foli edhe akademiku S. Gjinushi.




Me këtë rast, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela si dhe kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Skënder Gjinushi, nënshkruan një memorandum bashkëpunimi.

Në fund të këtij takimi, Akademia e Shkencave e Shqipërisë i dhuroi Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës një fond librash që i kishte sjellë enkas për bibliotekën e saj.

*23 Nëntor 2019*

**Drejtori i AZGJ-së Ylber Sela - pjesë e ekspozitës së përhershme "W. Wilson"**

Dje u kurorëzua në mënyrë të suksesshme manifestimi kulturor dhe shkencor disaditor "Ditët e Alfabetit të Gjuhës Shqipe", kushtuar 111-vjetorit të Kongresit të Manastirit, si dhe 12-vjetorit të themelimit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. Manifestimin e përshëndeti me një fjalim të shkurtër edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela.

Po ashtu folën edhe kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, ambasadori i Francës në Shkup, Kristian Timonie, drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore – Shkup, Skënder Hasani.




Mirënjohje shprehën edhe mysafirët amerikanë – Carolyn Dull – kryetare e Komunës Staunton të Virxhinias si dhe Robin Von Seldeneck, drejtoreshë e Muzeut të Bibliotekës Presidenciale "W. Wilson" në Staunton.

Të pranishmit i përshëndetën edhe kryetari i Komunës së Çairit, Visar Ganiu dhe albanologu David Hosaflook. Fjalë rasti pati edhe trashëgimtari i familjes së Hasan Prishtinës, Mehmet Prishtina.

*27 Nëntor 2019*

**Një ekip i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës sot vizitoi Komunën e Kumanovës**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, sot ka realizuar një takim pune me kryetarin e Komunës së Kumanovës, Maksim Dimitrevski .

Me këtë rast, drejtori Sela u njoh nga afër me procesin e zbatimit të gjuhës shqipe në këtë komunë, ndërsa e njoftoi kryetarin e saj edhe me punët dhe sfidat me të cilat po përballet AZGJ-ja.

Pas njoftimit për çështjet rreth funksionimit të agjencisë, fjalën e mori edhe kryetari Dimitriveski, i cili shprehu gatishmëri për zbatimin e Ligjit të Pëdorimit të Gjuhëve në institucionin të cilin e udhëheq, por se ka mungesë mjetesh për t'i zbatuar obligimet që dalin nga ky ligj.



Sela dhe Dimitrievski u dakorduan që të dyja institucionet të formojnë grupe pune për t'i shqyrtuar mangësitë e përdorimit të gjuhës shqipe, zgjidhjen e tyre dhe deri ku ka arritur zbatimi i saj.

*28 Nëntor 2019*

**Ambasadori i BE-së, Zhbogar vizitoi AZGJ-në**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela priti një delegacion të udhëhequr nga shefi i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e

Maqedonisë së Veriut, ambasadorin Samuel Zhbogar, i shoqëruar nga Virve Vimpari, këshilltare dhe udhëheqëse e njësisië së projekteve.

Në takim, drejtori Sela shprehu kënaqësi për vizitën e përfaqësuesit të lartë të BE-së dhe shprehu mirënjohjen e tij për këtë takim të drejtpërdrejtë dhe mundësinë për të shkëmbyer mendime, me çka ai e informoi ambasadorin Zhbogar për rolin jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe institucionalizimin e AZGJ-së e cila është e gatshme të mbështesë qeverinë për krijimin e një shoqërie demokratike e moderne, që garanton, respekton dhe promovon të drejtat gjuhësore të qytetarëve të saj në përputhje me standardet europiane.



Drejtori Sela, gjithashtu informoi bashkëbiseduesin e tij për nevojën e përforcimit të kohezionit dhe të bashkëpunimit ndëretnik shoqëror, si dhe përpjekjet për të krijuar mundësi për funksionimin e plotë teknik dhe operacional të AZGJ-së dhe, në këtë kontekst, shprehu gatishmëri për bashkëpunim me Delegacionin e BE-së për të mbështetur qëllimet dhe planet nga programi i AZGJ-së.



Ambasadori Zhbogar falënderoi drejtorin Sela për ftesën e tij, për të vizituar Agjenicinë e Zbatimit të Gjuhës dhe shprehu kënaqësi për entuziazmin dhe motivimin me të cilin drejtori Sela po përmbush misionin dhe qëllimin për të cilin u themelua AZGJ-ja.

Ambasadori Zhbogar shprehu interes për punën dhe projektet e planifikuara të AZGJ-së dhe shkëmbyen mendime me drejtorin Sela për sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhës, veçanërisht në gjyqësor. Gjatë vizitës, ambasadori Zhbogar dhe bashkëpunëtorja e tij shfaqën interesim edhe për kushtet në të cilat funksionon AZGJ-ja ku planifikohet edhe krijimi i një qendre trajnimi për përkthyes dhe korrektorë të kombinimeve gjuhësore maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht për nevojat e institucioneve publike.

Të dyja palët theksuan angazhimin e tyre për të vazhduar dialogun e përbashkët, si dhe komunikimin e rregullt dhe analizën e mundësive për të mbështetur AZGJ-në në zbatimin e projekteve të planifikuara.

*2 Dhjetor 2019*

**Vizitë e drejtorit Ylber Sela në Galerinë Nacionale**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, me bashkëpunëtorët e tij sot e vizitoi Galerinë Nacionale "Stacioni i Vogël" në Shkup, ku u prit nga drejtoresha e këtij institucioni, Dita Starova-Qerimi.



Në këtë takim u fol për procesin e zbatimit të dygjuhësisë. Meqë tanimë në tërësi ka përfunduar faza e parë e zbatimit të dygjuhësisë në këtë galeri, dy homologët në fjalë biseduan kryesisht për fazën e dytë, e cila do të fillojë të zbatohet prej muajit janar të vitit të ardhshëm.

Me këtë rast drejtoresha Dita Starova-Qerimi foli konkretisht për përgatitjet që po bën lidhur me jetësimin e fazës së dytë në praktikë, për angazhimin e kuadrit të përkthyesve dhe lektorëve, për mjetet e nevojshme që duhet të ndahen lidhur me përkthimin e katalogëve dhe botimeve të tjera në gjuhën shqipe etj.

Po ashtu, nga ana tjetër edhe drejtori Ylber Sela i dha mbështetje të plotë për sa i përket punës që po bën ajo në këtë institucion, konkretisht në fushën e përkthimit dhe korrigjimit të teksteve për nevojat e Galerisë Nacionale.

Në fund, drejtori Ylber Sela e përgëzoi homologen e tij për punën e suksesshme që po bën në Galerinë Nacionale gjë që u vërejt edhe sot në zbatimin e dygjuhësisë së plotë në këtë institucion, që nga tabelat në hyrje, logoja, vulat e deri te aktet, shkresat e udhëzimet e ndryshme brenda galerisë.

*3 Dhjetor 2019*

**Drejtori Sela u takua me zëvendësambasadorin gjerman Graff**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, realizoi takim pune me Oto Grafin, zëvendësambasador i Republikës Federale të Gjermanisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Në takim, drejtori Sela informoi bashkëbiseduesin e tij për rëndësinë e funksionimit të AZGJ-së për krijimin e një shoqërie kohezive multietnike e cila na shpie drejt integrimit, gjegjësisht shoqëri që garanton, promovon dhe avancon të drejtat e qytetarëve të saj, duke përfshirë edhe të drejtën për t'u shprehur dhe përdorur gjuhën e tyre amtare.

Zëvendësambasadori Graf shprehu gatishmëri për bashkëpunim me drejtorin Sela për të ngritur në një nivel tjetër dialogun dhe përkrahjen e ndërsjellë për punën e AZGJ-së drejt realizimit të përcaktimeve programore.

Të dyja palët u dakorduan që arsimi është njëri nga segmentet kryesore ku duhet të bëhen përpjekje më të mëdha për të thyer stereotipet e paragjykimet nacionaliste dhe se përmes politikave cilësore dhe të konceptuara mirë të arsimit mund të ndikohet pozitivisht në ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e pranimit dhe mësimit të gjuhës së bashkëqytetarit të një etnie tjetër si pasuri dhe mjet për komunikim dhe mirëkuptim të ndërsjellë.

*11 Dhjetor 2019*

**Drejtori Sela në vizitë pune në Austri**

Në kuadër të vizitës zyrtare të delegacionit të udhëhequr nga drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, në Austri, i shoqëruar edhe nga Tahir Hani- zëvendëssekretar i përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së, u realizua takim në selinë e Qendrës Hulumtuese EURAC në Vjenë, e ndodhur në kompleksin Vienna International Centre.



Takimi i punës ishte me Eleonora Musko nga selia e EURAC-ut në Vjenë, Sonja Gebert dhe Iskra Stojanova nga United Nations Environment Programme (UNEP), të cilat bashkëpunojnë me EURAC-un në projekte të përbashkëta.

Takimi ishte një mundësi e shkëlqyer për punën e deritanishme dhe aktivitetet për projekte të AZGJ-së dhe EURAC-ut, e gjithashtu u diskutuan mundësitë dhe fushat për bashkëpunim të mundshëm ndërinstitucional.



Gjatë vizitës në Vjenë, drejtori Sela realizoi takime edhe me përfaqësues të OSBE-së në zyrat e Hofburg Conference Centre, ku u takua me Mariana Roibu – oficere për përkrahje të politikave nga Reparti i Europës Juglindore, si dhe me Peter Mossop – këshilltar i veçantë, me të cilët u bisedua për bashkëpunimin e shkëlqyer deri tani ndërmjet AZGJ-së dhe Misionit të OSBE-së në Shkup, e njëkohësisht u theksuan edhe përpjekjet për vazhdimin e intensifikimit të dialogut reciprok.

*12 Dhjetor 2019*

**Drejtori Sela në vizitë të Qendrës Hulumtuese EURAC në Itali**

Pas vizitës së punës në Austri, delegacioni i udhëhequr nga Ylber Sela, drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, i shoqëruar nga Tahir Hani, zëvendëssekretari i përgjithshëm i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, e vizitoi Qendrën Hulumtuese EURAC në Bolzano, që është pjesë e provincës autonome të Tirolit Jugor, e cila paraqet një nga qendrat hulumtuese më eminente në Europë.

Në kuadër të vizitës së EURAC-ut, drejtori Sela realizoi takim pune me Andrea Abel – drejtoreshë e Institutit të Gjuhësisë së Zbatueshme, Klara Kranebiter – hulumtuese në Institutin e Gjuhësisë së Zbatueshme, Karolin Zviling – hulumtuese e lartë dhe koordinatore në Institutin e Federalizmit Krahasues, Mark Rogla – hulumtues në Institutin e të Drejtave të Pakicave, dhe Sabrina Kolombo – hulumtuese në Institutin e Gjuhësisë së Zbatueshme.




Takimi i punës ishte një mundësi e shkëlqyer për prezentimin e punës së AZGJ-së në kontekst të zbatimit të kompetencave që burojnë nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve dhe projekteve në drejtim të promovimit, mbrojtjes dhe

avancimit të gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ashtu si edhe prezentim të aktiviteteve të projekteve të EURAC-ut në lidhje me projektet aktuale në Europën Juglindore.

Të dyja palët shprehën interes për intensifikimin e dialogut reciprok dhe konkretizimin e bashkëpunimit përmes modalitetesh të ndryshme që përfshijnë shkëmbim të përvojave të ekspertëve në fushën e zbatimit të projekteve gjuhësore, përpilim të fjalorëve digjitalë terminologjikë, vizita studimore në nivel institucional dhe bashkëpunim të mundshëm për projekte shkencoro-hulumtuese.

*16 Dhjetor 2019*

**Sela takoi drejtorin e Shëndetësisë Elektronike "Termini im"**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, në kuadër të aktiviteteve të rregullta të punës, sot realizoi në takim me Refik Mustafin, drejtor në Drejtorinë e Shëndetit Elektronik – Shkup, që është organ i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.



Gjatë takimit, drejtori Sela me bashkëbiseduesin e tij shkëmbyen mendime rreth nivelit të deritashëm të realizimit të obligimeve që dalin nga dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Drejtori Mustafi e njoftoi drejtorin Sela mbi sfidat dhe pengesat e zbatimit të këtij ligji në drejtorinë që ai e drejton, duke marrë parasysh edhe kohën e shkurtër që nga emërimi i tij si drejtor, por shtoi se do të angazhohet që në bashkëpunim me agjencinë t'i tejkalojnë problemet që mund të shfaqen gjatë procesit të punës.

Palët u pajtuan se është i nevojshëm bashkëpunim mes dy institucioneve me qëllim të realizimit të obligimeve. Në anën tjetër, AZGJ-ja, me kapacitetet e saj, mbetet e hapur për bashkëpunim dhe mbështetje të kësaj drejtorie për të gjitha çështjet që burojnë nga zbatimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

*17.12.2019*

**Drejtori Ylber Sela vizitoi Inspektoratin Shtetëror të Inspektimit Teknik**

Në suaza të vizitave të zakonshme nëpër institucionet e ndryshme shtetërore, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela me bashkëpunëtorët e tij, e vizitoi edhe Inspektoratin Shtetëror të Inspektimit Teknik, ku u prit nga homologu i tij, Ekrem Bunjaku. Gjatë këtij takimi u fol lidhur me përfundimin e fazës së parë të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.



Me këtë rast, drejtori Ekrem Bunjaku, jo vetëm që e ka realizuar me sukses fazën e parë të ligjit në fjalë, por tanimë ai i prezentoi edhe të gjitha dokumentet zyrtare të fazës së dytë, të cilat i ka realizuar para kohe, siç janë: formularët e ndryshëm, memorandumi, procesverbali, libri i urdhëresave pagesore, libri i dorëzimeve interne, libri i postës, libri i regjistrimit të akteve, libri i pranimit të lëndëve, libri i parashtresave etj.

Në këtë mënyrë, zbatimi i dygjuhësisë në këtë institucion është bërë në mënyrë të plotë dhe mund të shërbejë si një shembull i mirë edhe për të gjitha institucionet e tjera në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

*18 Dhjetor 2019*

**Drejtori Ylber Sela vizitoi Fondin e Sigurimit Shëndetësor**

Vizita e sotme e drejtorit të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela dhe bashkëpunëtorëve të tij, si drejtim e pati Fondin e Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku u prit nga homologët e tij, Orhan Ramadani dhe Den Donçev.

Gjatë këtij takimi u fol për shumë çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e dygjuhësisë në këtë institucion, veçmas për vështirësitë dhe dilemat që shfaqen gjatë këtij procesi.



Faza e parë e zbatimit të dygjuhësisë në FSSH tanimë ka përfunduar, por faza e dytë po has në vështirësi dhe pengesa objektive për shkak të veprimtarisë shumë të gjerë në mbarë vendin, të cilat gjithsesi duhet të tejkalohen.

Edhe përkundër disa mospajtimeve të vogla që pati gjatë bisedës, të dyja palët ishin të mendimit se duhet të zbatohet ajo që është përcaktuar me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Me këtë rast drejtori Ylber Sela ofroi ndihmë konkrete për sa i përket përkthimit dhe lekturimit të dokumenteve dhe formularëve të ndryshëm për nevojat e këtij institucioni.

*19 Dhjetor 2019*

**Drejtori Sela në takim pune në Gjykatën Administrative**

Drejtori i AZGj-së, Ylber Sela, sot realizoi takim pune në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ç'rast u takua me Burim Sejdinin, kryetarin e kësaj gjykate.

Drejtori Sela e njoftoi B. Sejdinin për vështrimet dhe analizat rreth zbatimit të deritashëm të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve dhe për nevojën e zbatimit konsekuent të ligjit nga të gjithë faktorët, duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në nivel ndërinstitucional.



Kryetari Sejdini shprehu kënaqësinë e tij nga takimi me drejtorin Sela duke falënderuar për mbështetjen dhe bashkëpunimin që ofron AZGj-ja për institucionet për sa u përket përkthimeve dhe lekturimeve profesionale në çështje komplekse. Njëkohësisht, ai e informoi Selën rreth aktiviteteve të Gjykatës Administrative dhe theksoi nevojën e plotësimit të ekipit profesional, si dhe përforcimin e kapaciteteve profesionale të gjykatës me angazhimin e përkthyesve dhe lektorëve.

Gjatë takimit, të dyja palët e riafirmuan nevojën për forcimin e bashkëpunimit, duke pranuar rëndësinë që ka stimulimi i një ambienti social në respektimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të çdo qytetari, si dhe në promovimin, ruajtjen dhe përforcimin e të drejtës së qytetarëve për të përdorur gjuhët zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

*26 Dhjetor 2019*

**Drejtori Sela në takim pune me Kryetarin e Gjykatës Themelore Civile**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, sot realizoi një takim pune me Kryetarin e Gjykatës Themelore Civile - Shkup, Ilir Sulejmani.

Gjatë takimit, drejtori Sela shprehu kënaqësi për angazhimin dhe përkushtimin e kryetarit Sulejmani për zbatimin e fazës së parë të Ligjit të Zbatimit të Gjuhëve, duke pasur parasysh stafin e kufizuar dhe mjetet buxhetore që ka në dispozicion kjo gjykatë.



Kryetari Sulejmani theksoi se gjykata të cilën e administron ai, përfaqëson gjykatën më të madhe civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe se me angazhimin e tij personal dhe kapacitetet që disponon, ka përmbushur detyrimet e fazës së parë të Ligjit të Zbatimit të Gjuhëve, por ende

ka pengesa objektive për zbatimin e mëtutjeshëm të plotë të detyrimeve ligjore për shkak të mungesës së burimeve njerëzore kompetente, veçanërisht përkthyes, daktilografë dhe stafit tjetër profesional me njohuri të mirë të gjuhës shqipe dhe terminologjisë ligjore.

Qëllimi i këtyre takimeve kryesisht është në interes të qytetarëve për realizimin pa pengesë të të drejtave të tyre gjuhësore jo vetëm në proceset gjyqësore, por në të gjitha procedurat që përfshijnë zgjidhje ligjore, dhe Agjencia e Zbatimit të Gjuhës mbetet e gatshme për të bashkëpunuar me të gjitha palët që kanë për obligim zbatimin e dispozitave të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

*30 Dhjetor 2019*

**Drejtori i AZGJ-së takoi guvernatoren e Bankës Popullore të RMV-së**

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, sot realizoi një takim me kreun e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Anita Angelovska-Bezhoska dhe ekipin e saj për t'u njohur nga afër se sa ky institucion është i gatshëm dhe i përgatitur për t'i zbatuar obligimet që dalin nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve.



Drejtori Sela dhe guvernatorja Angellovska-Bezhoska shkëmbyen mendime për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Në anën tjetër, drejtori Sela tha se AZGJ-ja me kapacitetet e veta mbetet e hapur për bashkëpunim, duke ofruar përkrahje në pjesën e informacioneve këshillëdhënëse për zbatimin e këtij ligji, ashtu si edhe ndihmë në sigurimin e përkthimit dhe lekturës së formularëve dhe dokumenteve që burojnë nga puna e Bankës Popullore.

Këto takime janë në kuadër të tubimit të informacioneve për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve nga ana e institucionit të lartpërmendur.

Për vitin e ardhëshëm 2020 Agjencia e Zbatimit të Gjuhës do të vazhdojë t'i mbështesë  institucionet për zbatimin e plotë të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve,  që të sigurohen dokumentacionet dhe informacionet në gjuhët zyrtare në nivel qëndror dhe lokal ....

*30 Dhjetor 2019*

**Sela takon kryetaren e Komisionit të Letrave me Vlerë**

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, takimin e fundit zyrtar për 2019 e përmbyll me Nora Alitin – kryetaren e Komisionit të Letrave me Vlerë në RMV, e cila kryen kontrollin mbi gjithë dokumentacionin e emetuesve të letrave me vlerë.



Gjatë këtij takimi u fol për përfundimin e fazës së parë të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, ku kryetarja e këtij komisioni jo vetëm që e ka realizuar me sukses fazën e parë të ligjit në fjalë, por falë përkushtimit dhe punës së saj, Aliti ka ngritur në një nivel tjetër këtë proces, mu ashtu siç e parashikon edhe Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, dhe e zbaton me përpikëri në të gjitha dokumentet zyrtare.

Zbatimi i dygjuhësisë në këtë institucion është bërë në mënyrë të plotë dhe mund të shërbejë si një shembull i mirë edhe për të gjitha institucionet e tjera në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

## PJESA 6

### 6.1. Buxheti, llogaria përmbyllëse dhe financimi

AZGJ-ja si organ i pavarur shtetëror është shfrytëzues buxhetor.

Në vitin 2019, buxheti i përgjithshëm i aprovuar i AZGJ-së ishte 8.425.000,00 denarë. Me ribalancin e buxhetit të vitit 2019, buxheti themelor i AZGJ-së është rritur në një shumë prej 38,425,000.00 denarë. Nga shuma e përgjithshme e ribalancit të buxhetit të miratuar, 15.81 % ishin të parapara për pagat dhe shtesat, 53,48 % për mallra dhe shërbime dhe 30.71 % për shpenzimet kapitale.

**Struktura e buxhetit të AZGJ-së për vitin 2019**

| Zë | Përshkrimi | Buxheti për vitin 2019 | | | | | | RIBALANCI I BUXHETIT PËR VITITN 2019 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Buxheti (630) | Ribalanci | Shpenzimet nga të ardhurat e organeve (631) | Shpenzimet nga aktivitetet e vetëfinancuara (787/788) | Shpenzimet nga donacionet (785) | Shpenzimet totale | Shpenzimet totale |
| 40 | Pagat dhe kompenzimet | 6.075.000 | 6.075.000 | 0 | 0 | 0 | 6.075.000 | 6.075.000 |
| 401 | Paga bazë | 4.435.000 | 4.435.000 | | | | 4.435.000 | 4.435.000 |
| 402 | Kontributet e sigurimit social | 1.640.000 | 1.640.000 | | | | 1.640.000 | 1.640.000 |
| 42 | Mallrat dhe shërbimet | 2.050.000 | 20.550.000 | 0 | 0 | 0 | 2.050.000 | 20.550.000 |
| 420 | Udhëtimet dhe shpenzimet | 50.000 | 50.000 | | | | 50.000 | 50.000 |


| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ditore | | | | | | | |
| 421 | Shërbimet komunale, ngrohja, komunikimi dhe transporti | 900.000 | 1.500.000 | | | | 900.000 | 1.500.000 |
| 423 | Materialet dhe inventari i vogël | 100.000 | 1.000.000 | | | | 100.000 | 1.000.000 |
| 424 | Riparimet dhe mirëmbajtja e vazhdueshme | 100.000 | 1.000.000 | | | | 100.000 | 1.000.000 |
| 425 | Shërbimet kontraktuese | 850.000 | 15.000.000 | | | | 850.000 | 15.000.000 |
| 426 | Shpenzimet e tjera rrjedhëse | 50.000 | 2.000.000 | | | | 50.000 | 2.000.000 |
| 48 | Shpenzimet kapitale | 300.000 | 11.800.000 | 0 | 0 | 0 | 300.000 | 11.800.000 |
| 480 | Blerja e pajisjeve dhe makinerive | 200.000 | 6.000.000 | | | | 200.000 | 6.000.000 |
| 483 | Blerja e mobiljeve | 100.000 | 1.800.000 | | | | 100.000 | 1.800.000 |
| 485 | Investimet dhe mjetet jofinanciare | 0 | 4.000.000 | | | | 0 | 4.000.000 |

## 6.2. Furnizimet publike

1. Numri i vendimeve të marra për furnizime publike: 14
2. Numri i konkurseve të shpallura në SEFP për furnizime publike: 14
3. Numri i procedurave të filluara me bisedime pa shpallje paraprake të konkursit, në përputhje me nenin 99 paragrafi (1) pika 1 alineja 2 nga LFP: /

4. Numri i vendimeve të marra për përzgjedhje të ofertës më të favorshme: 14
5. Numri i kontratave të lidhura për furnizime publike me vlerë të përgjithshme: 15.450.006,00 denarë pa TVSH, gjegjësisht 17.761.636,00 denarë me TVSH.

| Numri i vendimeve të marra për furnizime publike | Konkurset e shpallura në SEFP | Numri i procedurave negociuese të filluara pa publikim paraprak të shpalljes | Numri i kontratave të lidhura |
|---|---|---|---|
| 14 | 14 | 0 | 14 |




## PIKËPAMJE PËRFUNDIMTARE

AZGJ mbetet dhe do të vazhdojë të jetë edhe në të ardhmen një faktor aktiv institucional në kryerjen e përgjegjësive të saj në mënyrë efikase dhe efektive, në përputhje me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve dhe në vazhdimësi do të bashkëpunojë me institucionet dhe organizatat relevante të vendit dhe ato ndërkombëtare, si dhe do të ndërmarrë aktivitete për mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.


AGJENCIA E ZBATIMIT TË GJUHËS E RMV-së

Shëtitorja "Dimitar Vllahov" nr. 4, kati i katërt,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut


Ky raport është botuar në mars të vitit 2020
Në dispozicion në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze.

**E drejta e autorit është e drejtë ekskluzive e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës**
**Adresa: shëtitorja "Dimitar Vllahov" nr. 4, kati IV,**
**1000 Shkup**
**Tel: +389 23121731**
**e-mail: info@apj.gov.mk;**
**www.apj.gov.mk**
**www.azgj.gov.mk**